| | | ***I*** | ***II*** | ***III*** | ***IV*** | ***V*** | ***VI*** | ***VII*** | ***VIII*** | ***IX*** | ***X*** | ***XI*** | ***XII*** | ***Totali*** |
| ***1*** | ***Pneumonia*** | ***20*** | ***12*** | ***17*** | ***15*** | ***7*** | ***4*** | ***2*** | ***10*** | ***6*** | ***10*** | ***17*** | ***15*** | ***135*** |
| ***2*** | ***Diarrhea ac*** | ***114*** | ***56*** | ***79*** | ***64*** | ***97*** | ***125*** | ***223*** | ***528*** | ***221*** | ***138*** | ***49*** | ***52*** | ***1746*** |
| ***3*** | ***Varicella*** | ***28*** | ***19*** | ***19*** | ***18*** | ***13*** | ***12*** | ***22*** | ***3*** | ***8*** | ***18*** | ***35*** | ***61*** | ***256*** |
| ***4*** | ***SARI(inf.res.rënd)*** | ***1*** | ***0*** | ***6*** | ***5*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***1*** | ***0*** | ***10*** | ***23*** |
| ***5*** | ***Dyshimi në Influencë*** | ***811*** | ***829*** | ***225*** | ***87*** | ***76*** | ***44*** | ***41*** | ***42*** | ***66*** | ***92*** | ***165*** | ***111*** | ***2589*** |
| ***6*** | ***Sy.etheve hemorrh*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** |
| ***7*** | ***Sy diaresë me gjak*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** |
| ***8*** | ***Meningjiti bakterial*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** |
| ***9*** | ***Meningjiti viral*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** |
| ***10*** | ***Parotiti Epidemik*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***1*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***7*** | ***0*** | ***8*** |
| ***11*** | ***Sy verdhëzës ac*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***1*** | ***1*** |
| ***12*** | ***Pertussis (kola e keqe)*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** |
| ***13*** | ***Tularemia*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***1*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***1*** |
| ***14*** | ***Brucellosa*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** |
| ***15*** | ***Tuberkulozi*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** |
| ***16*** | ***Scabiesi*** | ***86*** | ***73*** | ***52*** | ***70*** | ***42*** | ***23*** | ***52*** | ***32*** | ***20*** | ***39*** | ***53*** | ***53*** | ***595*** |
| ***17*** | ***Sëm.tjera inf.*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** | ***0*** |
| ***Totali semundjeve.infektive/muajve*** | | ***1060*** | ***989*** | ***398*** | ***260*** | ***235*** | ***208*** | ***340*** | ***615*** | ***322*** | ***298*** | ***326*** | ***303*** | ***5354*** |

***Paraqitja tabelare dhe grafike e Sëmundjeve ngjitëse sipas muajve gjatë vitit 2011***




***Koment: i Paraqitjes tabelare dhe grafike të Sëmundjeve ngjitëse sipas muajve gjatë vitit 2011***

Në komunen e Drenasit si që shihet nga të dhenat tabelare të mësipërme për vitin 2011 dominon gripi (Influenca) me 2589 raste të paraqitura nga mjeket ose shprehur ne përqindje ( 48,4 % )apo gjysma e të gjitha sëmundjeve ngjitëse në komunen tonë, por dyshohet se numri eshte shume me i madh. Këtë vit nga IKSHPK jane siguruar mbi 1500 doza vaksina kunder kesaj semundje dhe te gjitha vaksinat jane dhene pacienteve sipas indikacioneve epidemiologjike. Këtë vit nuk janë shënuar raste të shumta të dyshimta në SARI (infeksionerespiratore të rënda) gjithsejtë 23 raste apo (0.43%)

Pastaj dominojnë sëmundjet e zorreve me 1746 raste apo (32.6%),hepatit virosa me 1 rast ,këto sëmundje janë indikatoret e gjendjes së rendë socio-ekonomike, sëmundje që zakonisht hasën gjatë stines së veres, që jane pasojë e pakujdesisë së higjienes së duareve ,mungesës së ujit higjienik si dhe ruajtja jo emire e produkteve ushqimore.

Pason scabiesi me 595 raste ose (11.11 %)e cila tregon edhe njehere gjendjen e rendë ekonomiko-sociale të popullates dhe nivelin e ulet të higjienes.

Pastaj pason Variçella (lija e ujit) me 256 raste ose 4.8% -sëmundje që prek fëmijet në moshë të hershme dhe që eshte me prognozë të mirë për të cilen ne Kosovënuk jepet vaksinë . Këtë vit kemi qenë të detyruar që te kryejme vizita mjekesore ne shkollen fill.të Negrocit dhe të Sankocit për shkak së variçella është përhapur në numër të madh te nxënësit ngase kemi qenë të ftuar nga shkollat përkatëse për vizita mjekësore.

Pneumonia me 135 raste apo 2.52 % zenë vend të konsiderueshem në morbiditet që vjen si pasojë e paraqitjes së vonshme për vizitë mjekësoretw pacienteve.

Tularemi kemi tëparaqitur vetem një (1)rast

Në të gjitha rastet gjatë vitit 2011 sikur edhe viteve tjera , sektori i Shendetit publik përkatësisht njësia epidemiologjike e udhëhequr nga epidemiologu dhe në bashkpunim me Drejtorinë Komunale të Shëndetësisë gjithnjë kemi patur nën kontrollë situaten epidemiologjike duke marr mostrat egzaminuese (uji ,koprokultura ,hemokultura ,këshillimi mbajatjae ligjerateve) të dyshuarit janë hospitalizuar si dhe janë marrë masat preventive për parandalimin e epidemive të mundshme.

**Pasqyrëza e të dhënave dhe suksesi i vaksinimit 94.9%**

**Raporti i Vaksinimit 2010**

| Vaksinat | Dozat | Planifikuar | Vaksinuar | Suksesi % | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|
| DTP | Doza I | 1186 | 1129 | 95.19 | |
| | Doza II | 1186 | 1110 | 93.59 | |
| | Doza III | 1186 | 1017 | 85.75 | |
| OPV | Doza I | 1186 | 1129 | 95.19 | |
| | Doza II | 1186 | 1110 | 93.59 | |
| | Doza III | 1186 | 1017 | 85.75 | |
| BCG | | 910 | 910 | 100.00 | 341 Drena |
| MMR | | 1070 | 1002 | 93.64 | |
| DTP Riv | | 1070 | 960 | 89.72 | |
| OPV Riv | | 1070 | 960 | 89.72 | |
| MMR Riv | | 1036 | 1026 | 99.03 | |
| HBv Riv | Doza I | 910 | 910 | 100.00 | 341 Drena |
| | Doza II | 1186 | 1129 | 95.19 | |
| | Doza III | 1186 | 1110 | 93.59 | |
| | Doza IV | 1186 | 1017 | 85.75 | |
| Dt-ped | | 1036 | 1026 | 99.03 | |
| OPV Riv II | | 1036 | 1026 | 99.03 | |
| Dt pro ad | | 1086 | 1052 | 96.87 | |
| OPV Riv III | | 1086 | 1052 | 96.87 | |
| TT | | 1002 | 995 | 99.30 | 666 lëndi. |
| **TOTALI** | | **21986** | **20687** | **94.09** | |

Nr i fëmijëve të vaksinuar në Maternitet me vaksinën e **BCG** dhe **Hepatit B** është **341 raste.**
Nr i të vaksinuarve pas lëndimeve me vaksinë **TT është 666 raste.**

## Drejtorati për Arsim

Raporti i punës i Drejtorisë Komunale për Arsim, më tej ( DKA ) paraqitur Kryetarit të Komunës së Drenasit z.Nexhat Demaku, është mbi bazën e Ligjit nr. 03/L-68 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, si dhe në bazë të Statutit të Komunës së Drenasit të nenit 79. Në këtë dokument janë përfshirë detyrat, përgjegjësitë, aktivitetet, të arriturat dhe sfidat e sektorit të arsimit gjatë vitit 2011.

Fillimin e vitit kalendarik 2011 e karakterizoi edhe fillimi i gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2010/11, ku procesi edukativ-arsimor u zhvillua pa asnjë pengesë më të vogël. U bënë vizita zyrtare për të monitoruar gjendjen në përgjithësi deri tek përmbyllja me sukses e vitit shkollor. Menjëherë DKA planifikoi përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2011/12 me punë intensive përmes dy konkurseve bëri rekrutimin e kandidatëve për plotësimin e kuadrit arsimor. Vlenë të theksohet se për çdo vit e më shumë po zvogëlohen vendet e lira të punës. Kjo është dukuri pozitive, pasi janë duke diplomuar gjenerata të reja të drejtimeve deficitare që kishte Komuna e jonë.

Në këtë raport pasqyrohet gjendja e institucioneve arsimore me të dhënat e detalizuara, si dhe paraqitja e të gjitha aktivitetet që janë zhvilluar gjatë vitit 2011. Poashtu është përcjellur edhe dinamika e ndërtimit të shkollave të reja në Komunën tonë. Në këtë raport njëvjeçar janë paraqitur të dhënat për të gjitha investimet kapitale dhe pedagogjike.

Më 1 shtator në ditën e parë të mësimit, u inaugurua objekti i ri i SHMT
” FEHMI LLADROVCI” në Drenas, i cili tanimë me hapësirë të mjaftueshme dhe me kushte moderne arriti shumë përparime të jashtëzakonshme, në radhë të parë zvogëloi ndërrimin nga tre në dy dhe nxënësit që mësonin në paralelen në Komoran tani janë në objekt të ri në Drenas. Edhe në Gjimnazin „GJ.K.SKËNDERBEU” në Drenas u bënë disa ndryshime në organizimin e brendshëm të objektit, si dhe me projektin e Bankës Botërore u vendosën kamerat për monitorim dhe shndërrimi i kalldajës nga ajo me naftë në dru e thëngjill, e cila dukshëm e ka ndryshuar gjendjen ku përgjatë sezonës dimërore tërë lokali kishte nxemje të shkëlqyeshme, e cila me vite i ka munguar këtij institucioni arsimor. Gjithashtu me disa projekte të Bankës Botërere u përmirësua gjendja në disa shkolla fillore dhe të mesme të ulëta duke u pajisur me teknologji arsimore, të cilat e kanë rritur cilësinë në arsim dhe rezultatin e nxënësve në përgjithësi në nivel komunal. Rezultatet në arsim në Komunën tonë në përfundim të secilit vit shkollor nga vlerësimi i jashtëm për katër vite, nga 2008-2011 do t’i paraqesim me diagrame.

Edhe për vitin e ri shkollor 2011/12 u dhuruan nga MASHT-i tekste falas për nxënësit e arsimit të obliguar, ndërsa DKA shpërndau lëndën djegëse dhe gjysmëvjetori i parë shënoi progres.

Ndër karakteristikat e vaçanta të DKA-së në vitin 2011 ishte vlerësimi i bërë nga Komisioni Evropian, në bashkëpunim me OSBE-në dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës, ku DKA në Drenas shpallet më e mira në nivel shtetëror. Për këtë ngjarje të jashtëzakonshme deri më tani, më 01.12.2011 në Komunën tonë është mbajtur takimi me drejtorët e DKA-ve të Republikës së Kosovës dhe është bërë prezantimi i përvojave më të mira në Kosovë për funksionimin dhe aktivitetet plotësuese.

## STRUKTURA ORGANIZATIVE

**Në Drenas funksionojnë 39 objekte të institucioneve arsimore.**
**Në vitin shkollor 2011/12, Mësimin e rregullt janë duke e ndjekur 14721 nxënës ose 612 më pak se në vitin e kaluar.**

- Një I.Parashkollor amë+1paralele (127 fëmijë)
- Qendra Parafillore "Dielli"(134 fëmijë )
- 36 paralele me parafillore (734 fëmijë)
- 3 paralele (16 fëmijë) me nevoja të veçanta
- 29 SHFMU+5 paralele(10031 nxënës)
- Gjimnazi numëron 1777 nxënës, ndërsa
- SHMT numëron 1902 nxënës.

**Sektori i arsimit numëron 956 punëtorë:**

- 7 punëtorë – personel administrativ në DKA,
- 22 punëtorë në arsimin parashkollor,
- 749 punëtorë në arsimin fillor dhe i mesëm i ulët,
- 178 punëtorë në arsimin e mesëm të lartë.

**Prej tyre:**

- 47 janë punëtorë administrativ,
- 770 mësimdhënës dhe
- 139 punëtorë shërbyes-teknik.

Në Institucionin parashkollor "ARDHMËRIA " në Drenas me qëndrim tërëditor janë tre grupe prej 20 fëmijëve prej moshës 0-3 vjeç, kopshti nr.1 në Drenas me tre grupe prej 55 fëmijëve të moshës 3-6 vjeçar, ndërsa kopshti nr.2 në Bushat ka 52 fëmijë. Ndërsa paralelet me parafillor me plan-programin e MASHT-it dhe në bashkëveprim me Karitasin e Zvicrës, mësimin e vijojnë 734 fëmijë, vetëm në Qendrën Exellente " DIELLI" ka pesë paralele në të cilat mësimin e vijojnë 134 fëmijë të moshës 5-6 vjeç.

Ndërkaq arsimi special zhvillohet në tre paralele të bashkangjitura në SHFMU " 28 NËNTORI " në Kroikovë, ku vijojnë mësimin 16 fëmijë nga mosha 6-14 vjeç.

Arsimin e mesëm të lartë e përbënë Gjimnazi "GJ.K.SKËNDERBEU" që ka 44 paralele në tre drejtime: Gjimnazi i shkencave shoqërore, shkencave të natyrës dhe shkencave kompjuterike, dhe SHMT "FEHMI LLADROVCI" që ka 62 paralele në pesë drejtime me 17 profile teknike.

## REALIZIMI I AKTIVITETEVE TË OBLIGUARA

Gjatë këtij viti DKA ishte e angazhuar në shumë aktivitete të planifikuara dhe disa në bashkëpunim me MASHT-in:

- Janë vizituar dhe inspektuar të gjitha institucionet arsimore nga DKA dhe herë-herë në bashkëpunim me inspektorët e MASHT-it.
- Është mbajtur testi i brendshëm për maturantët e SHMT " FEHMI LLADROVCI " – Drenas.
- Janë mbajtur mbledhjet e rregullta mujore me drejtorë të institucioneve arsimore, arsimtarë dhe prindër të nxënësve.
- Është planifikuar regjistrimi i nxënësve në klasat e dhjeta në arsimin e mesëm të lartë.
- Është mbajtur Testi për klasën e pestë më 22.04.2011 në dhjetë shkolla.
- Është mbajtur Testi i Maturës shtetërore në dy afate të rregullta më 04 Qershor, më 28 Gusht dhe më 06 Shtator. Kalueshmëria ishte 51 % në nivel komunal.
- Është mbajtur Testit të Arritshmërisë për klasën e nëntë, më 29.06.2011. Kalueshmëria 53,75 % në nivel komunal.
- Janë nxjerrur statistikat e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2010/11.
- Janë regjistruar nxënësit në klasën e parë të vitit shkollor 2011/12.
- Janë nxjerrur statistikat e gjysmëvjetorit e parë të vitit shkollor 2011/12.
- Janë shpërndarë tekstet shkollore nga kl I-IX, që janë dhënë falas nga MASHT-i edhe për vitin shkollor 2011/12.
- Janë nxjerrur të dhënat për nxënësit e riatdhesuar prej periudhës së pasluftës nga viti 2000 e deri në vitin 2011.
- Është bërë regjistrimi i pasurisë së institucioneve arsimore.
- Është hartuar plani financiar për DKA-në për vitet 2012/14.
- Është hartuar planifikimi i vitit shkollor 2011/12.
- Janë shpallur dy konkurse për pranimin e kuadrit arsimor
- Janë kryer me sukses intervistimet dhe procedurat ligjore për pranimin e kuadrit arsimor për vitin shkollor 2011/12
- Janë bërë shumë vizita zyrtare në institucionet arsimore.
- Shpërndarja e lëndës djegëse në të gjitha shkollat është kryer me sukses.

## REALIZIMI I AKTIVITETEVE TË LIRA

- Janë realizuar disa trajnime për mësimdhënës me tema: " psiko-sociale ", "nxënësi në qendër "nga QPEA-Ferizaj, ku përveç mësimdhënësve kanë marrur pjesë edhe nxënës e prindër të tyre. Ky lloj kombinimi në trajnime ka shënuar suksese pozitive.
- Janë realizuar një mori aktivitetesh të lira dhe vullnetare nga grupet vullnetare në të gjitha institucionet arsimore
- Janë realizuar aktivitete në institucionet arsimore për shënimin e 17 Shkurt për Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës.
- Janë zhvilluar aktivitete kulturore në shënimin e 7 Marsit – Dita kombëtare e mësuesit.
- Është organizuar 22 Prilli - Dita Ndërkombëtare e Vajzave, ku janë realizuar punëtori të ndryshme me grupe të vajzave në disa punëtori të bizneseve të ndryshme në Komunën e Drenasit.
- Është shënuar 9 Maji - Dita e Planetet Tokë me organizime për pastrimin e ambientit në shkolla dhe në Qytet.
- Janë mbajtur gjatë muajit maj aktivitete sportive dhe kulturore në bashkëpunim me DKRS.
- Është realizuar vizitë studimore me rastin e festës së punëtorëve, më 1 Maj, ku sipas agjendës programore në bërbërje të delegacionit ishin 47 persona: drejtorët e institucioneve arsimore në Drenas dhe disa mësimdhënës të lëndës së historisë, gjeografisë dhe edukatës qytetare në monumentet e kulturës dhe historisë shqiptare në Shtetin Shqiptar. DKA ka participuar vetëm me sigurimin e autotransportuesit.
- Është organizuar Darka Tradicionale e mësimdhënësve me Kryeministrin e Republikës së Kosovës, z.Hashim Thaçi më 21.06.2011.

## REALIZIMI I PROJEKTEVE KAPITALE

- Është ndërtuar aneksi dhe është renovuar objektit aktual i SHFMU " NAIM FRASHËRI " në Bletar, në vlerën prej **223,915. oo €.** Në këtë investim ka participuar USAID-i Amerika në vlerë prej **90,000.oo€**. Ndërsa Komuna e Drenasit ka financuar vlerën prej **133,915.00€**.

- Është inauguruar më 1 shtator 2011 objekti i ri i SHMT " FEHMI LLADROVCI " në Drenas, investim i Qeverisë në vlerë prej **2.600,000 €.**

- Është renovuar objekti i SHFMU " REGJEP GJELI " në Likoshan, investim nga Komuna në vlerë prej **9,000.00 €.**

- Është bërë investimi në renovimin e nyjeve sanitare në objektin e SHFMU "MIGJENI " në Baicë, projekt i Komunës që ka kushtuar **5,000.00 €.**

- Është përfunduar ndërtimi i rrethojës në oborrin e SHFMU " HALIL BAJRAKTARI " –Drenas II, në vlerë prej **6,000.00 €.**

- Është bërë ndërrimi i kalldajës së nxemjes qendrore nga naftë në dru ethëngjill në Gjimnazin " GJ.K.SKËNDERBEU" –Drenas II, në vlerë prej **9,160.00 €.**

- Është bërë ndërrimi i kalldajës së nxemjes qendrore nga naftë në dru e thëngjill në SHFMU " SHOTË GALICA" –Abri e Epërme në vlerë prej **9,000.00 €.**

- Hapja e puseve të ujit të pijës në shkollat në: Tërstenik dhe Nekoc nga Drejtoria e Urbanizmit, ndërsa nga donatorët u investua në hapjen e puseve dhe instalimin e pompave të ujit në: Drenas I, Gllobar, nga ( Shoqata **" MAGBULEJA"** dhe nga Shoqata Islamike **WVAKF** janë hapur puset dhe vendosja e pompave në shkollat e fshatrave:Kroikovë dhe Arllat), ndërsa nga buxheti i DKA-së janë instaluar pompat e ujit në shkollat e fshatrave: Gradicë, Godanc dhe Shkabë në vlerë prej **8,260.00 €.**

- Investim në Teknologji Informative në disa shkolla sipas nevojës në vlerë prej **11,176.00 €.**

- Është bërë investim në rrjetin e ujësjellësit në Gjimnazin "GJ.K.SKËNDERBEU" –Drenas II, në vlerë prej **8,234.00 €.**

- Transporti i nxënësve në gjysmëvjetorin e pare të vitit shkollor 2011/2012 në vlerë prej **56,650.00 €.**

- Rrethoja në SHFMU " ALI GASHI "-DrenasIII investim nga Drejtoria e Urbanizmit që ka kushtuar **14,940.45 €.**

## REALIZIMI I PROJEKTEVE PEDAGOGJIKE

- Janë dhënë 100 bursa për studentë nga DKA-së në vlerë prej 200 € në kokë studenti, për tërë vitin akademik 2010/11. Ky subvencion inshte në vlerën totale prej **20.000.oo €** (njëzetëmijë euro).

- Janë përkrahur me dhënjen e 67 bursave për nxënësve të dy shkollave të mesme të larta në Drenas, donacioni SOLON i Zvicrës, përmes QPEA- Ferizaj e menaxhuar nga DKA në vlerë prej 30 € në muaj, ky investimi ka vlerën prej **20,100. oo €.**

- Është hapur në muajin mars kabineti i firmës ushtrimore për drejtimin e ekonomisë në SHMT " FEHMI LLADROVCI ". Ky investim është donacion nga shteti i Austrisë përkatësisht nga kulturë kontakti.

- Komisioni Europian ka investuar në hapjen e Kabinetit të Informatikës në SHMT " FEHMI LLADROVCI " në Drenas.

- DKA ka përfituar shtatë grante nga Banka Botërore në vlerën totale prej **49,820.00 €** për këto shkolla:

1.Gjimnazi "GJ.K.SKËNDERBEU " në vlerë **15,000.00 €.**

2.SHFMU "SHOTË GALICA " në vlerë **6,480.00 €.**

3.SHFMU "DËSHMORËT E QËNDRESËS II " në vlerë **5,485.00 €.**

4.SHFMU "XHEVË LLADROVCI " në vlerë **5,435.00 €.**

5.SHFMU "DËSHMORËT E DRENICËS " në vlerë **5,140.00 €**.

6.SHFMU "28 NËNTORI " në vlerë **5,896.00 €.**

7.SHFMU "ALI GASHI " në vlerë **6,384.00 €.**

**Për këto projekte DKA- ka participuar 3,642.00 €.**

## BASHKËPUNIMET DHE INTEGRIMET

Gjatë periudhës raportuese, DKA ka pasur bashkëpunime të sinqerta në radhë të parë në vetë stafin e DKA-së, ku me një angazhim edhe jashtë normave zyrtare kemi ruajtur dhe integruar në vazhdimësi bashkëpunime edhe me MASHT-in, Komunën, donatorët dhe me të gjithë factored e tjerë relevant që kanë ndikim në institucionet arsimore të Drenasit. Në saje të bashëpunimit veçojmë disa prej tyre:

-Si rezultat i bashkëpunimi me USAID-in Amerikan, kemi përfituar projektin BEP ( Basic Education Program) d.m.th. Programi për Arsimin Themelor në kuadër të së cilit është hapur Klasa e Shek. 21 dhe QNP – Qendra për Ngritje Profesionale në objektin e SHFMU "Halil Bajraktari" në Drenas II. Komuna jonë ishte në mes të tre komunave të para të Republikës së Kosovës që ka përfituar këtë projekt, ku dhe kemi marrur pjesë në një vizitë studimore në Londër të organizuar nga BEP-i me tre drejtorët komunal të arsimit dhe zyrtarë të lartë të MASHT-it. Është vizituar Panairi Ndërkombëtar i teknologjisë arsimore – BETT, si dhe në selinë e Mikrosoft-it.

Edhe gjatë këtij viti, ka vazhduar kursi për ECDL për mësimdhënësit e Komunës sonë që funksionon me dy salla nga AUK-u dhe SBASHK-u sipas orarit të planifikuar më parë.

-Ka vazhduar bashkëpunim me nxënësit shqiptar në Suedi, të cilët janë mirëpritur nga DKA dhe Shkolla " LUIGJ GURAKUQI " –në Flamuras.

-Nga bashkëpunimi me Holandën, kemi pranuar në muajin Prill 2011 një kamion me ndihma vullnetare kryesisht inventar shkollor dhe kënde të lojrave e paisje sportive për nxënës në Shkollën " ZENEL HAJDINI " në Qëndresë I.

Ne kemi realizuar një vizitë në Holandë më 11 - 21 Maj 2011 me nxënës dhe profesor të arsimit të mesëm të lartë të Drenasit. Atje janë realizuar shumë vizita në kultura bimore dhe shtazore me nxënësit, të cilët kanë qenë të angazhuar edhe në aktivitete pune së bashku me nxënësit holandezë. Nga kjo vizitë kësaj radhe realizuam takim me Drejtorin e Arsimit të Komunës – Dordrecht dhe Gjimnazin më të vjetër të këtij qyteti.

Nga Shkolla Wellantcollege kemi kërkuar bashkëpunime profesionale, gjë që kemi filluar tanimë me shkëmbime profesionale. Atje kanë shkuar në muajin tetor një ekip prej tre mësimdhënësve në trajnime dyjavore në lëminë e bujqësisë.

# SUKSESI I ARRITSHMËRISË 2008-2011




# SUKSESI I MATURËS 2008-2011



## PËRFUNDIMI

Gjysmëvjetori i dytë i vitit shkollor 2010/11 me gjithë rezultatet e arritura në të gjitha fushat e organizimit të DKA-së, ka qenë i stërngarkuar me staf edhe më të kufizuar deri më tani.

Krahas sfidave që kemi pasur në sferën e arsimit në Komunën e Drenasit gjatë periudhës gjashtëmujore mund të raportojmë se kemi arritur edhe suksese të jashtëzakonshme. Si Komunë e vogël siç është Drenasi, ishte shumë e suksesshme vlerësimi i bërë nga Komisioni Evropian, në bashkëpunim me OSBE-në dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës, ku DKA në Drenas u shpall më e mira në nivel shtetëror në funksionim dhe në aktivitetet plotësuese, si dhe njëherit jo vetëm në sferën e arsimit, por të gjitha sferave të tjera qeverisëse, doli si drejtorati më i komplentuar i qeverisjes lokale në teritorin e Republikës së Kosovës. Këtë vlerësim e ka publikuar AKK-ja në Buletinin mujor të tyre.

Sa i përketë ecurisë së procesit edukativ-arsimor gjendja është dukshëm duke u përmirësuar. Kjo dëshmohet me ngritjen e cilësisë dhe krijimit të ambienteve të pastërta nëpër shkolla. Këtë e ka bërë të mundur vetëdijesimi më i lartë, shkalla e transparencës me decentralizimin e buxhetit në linjën buxhetore për mallra dhe shërbime për secilin institucion arsimor që nga janari 2011. Kjo që ka bërë DKA në Drenas nuk e ka bërë asnjë Komunë në Republikën e Kosovës, përveç tre komunave që janë në pilotim nga Qeveria ( Gjilan, Kaçanik dhe Burim).

Ndër ngjarjet tjera të suksesshme që e karakterizuan vitin 2011 për zhvillime dhe integrime edukative-arsimore e veçojmë bashkëpunimin me USAID-in –Amerikan, Karitasin e Zvicrës për edukimin parafillor, si dhe Marrëveshjen e arritur më 04 Maj 2011 në mes Universitetit të Prishtinës, IPF-Multiversity dhe DKA-së për mundësinë e fillimit të studimeve në Drenas në Degën e parafillorëve në kuadër të Fakultetit të Edukimit të UP-së.

## Drejtorati për Buxhet dhe Financa

Drejtorati për Buxhet dhe Financa, gjatë vitit 2011 punët dhe detyrat ë punës i ka kryer duke u bazuar në planë-programin e punës, të mbështetur në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit nr. 2003/2, Ligjin për Financat e pushtetit Lokal nr. 03/L-049, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L- 040, rregulloret, vendimet , udhëzimet e MF-së dhe Kuvendit të Komunës; si dhe në bazë të detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me Statutin e Komunës.

Ky Drejtorat , punën e vetë kryesit e ka orjentuar në këto lëmi:

- plani i punës për vitin 2011,
- raporti i punës dhe raporti financiar për vitin 2010,
- pasqyrëzat financiare për vitin 2010,
- procesi buxhetor – Strategjia Fiskale 2012-2014,
- raportet financiare sipas periodave të vitit 2011,
- pasëqyrëzat financiare sipas periodave të vitit 2011,
- aprovimi i shpenzimeve dhe çertifikimi për Buxhetin Komunal sipas karakterit ekonomik dhe funksional,
- kryerja e pagesave lidhur me shpenzimet operative dhe kapitale ,si dhe barazimet me raportet SIMFK,
- punët lidhur me arkën e parave të gatshme arkëtimi dhe pagesat,
- regjistrimi i të hyrave të arketuara nga burimet vetanake në sistem, si dhe barazimi ditor,javor,mujor dhe periodik me SIMFK,
- përcjellja e të hyrave publike të akorduara nga F.K,
- përgatitja e transfereve të parave të depozituara në llogaritë e D. Thesarit- MF,
- përgatitja dhe caktimi i tatimit në pronë , si dhe përcjellja e shpërndarjes së faturave,
- caktimi i taksave dhe ngarkesave tjera,
- evidentimi i objekteve të reja si pasuri e palujtshme dhe rimatja e objekteve të matura,
- pergatitja eanalizave mujore lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal,

- punët lidhur me pergatitjen e propozim-vendimeve dhe vendimeve për Buxhetin e Komunës,
- pergatitja e Kornizes Afatmesmeve të Shpenzimeve 2012-2014,
- shlyerja e pagesave për tatimin në pronë,
- plotësimi i formularëve për Buxhetin Komunal në Sistemin e BDMS-së, për kategori kryesore të shpenzimeve dhe për programe- nën programe,
- punët lidhur me rishikimin e Buxhetit Komunal,
- trajnimi i punëtorve të DBF,
- punë me palë në lëmin e Financave Publike, si dhe
- punë dhe detyra tjera të punës për Pushtetin Lokal dhe atë Qendror.

Struktura e Përgjithshme organizatiove për funksionet ë D.B.F , është e ndërtuar në tri sektore dhe në Zyrën eTatimit në Pronë; ndërsa gjatë vitit raportues kanë punuar 12 shërbyes civil, prej të cilëve katër me fakultet, tre me shkollë të lartë, ndërsa pesë me shkollim te mesëm. Vlenë të theksohet se të gjithë punëtorët që punëjnë me SIMFK janë të çertifikuar.

**1.Sektori I Buxhetit.-** Për perioden janar- dhjetor të vitit 2011, ka kryer këto punë dhe detyra pune:

- pergatitja e planit të zotimit dhe shpënzimit të parasë publike sipas kategorive kryesore ekonomike të shpenzimit, dhe sipas programeve-nën programeve buxhetore të bazuara në burimet ë financimit,

- informimi I programeve lidhur me buxhetin e miratuar,

- zhvillimi i aktiviteteve lidhur me planifikimin e buxhetit komunal 2012-2014 sipas kërkesave fillestare,

- përgatitja e Kornizes Afatëmesme Buxhetore të Shpenzimeve 2012-2014,

- pergatitja e tri qarkoreve interne buxhetore,

-Pergatitja lidhur me takimet ë mbajtura me qytetarët për dëgjim bugjetor,

-aktivitetet lidhur me planifikimin e bugjetit komunal sipas kërkesave finale,

-pergatitjae propozimvendimit për bugjetin komunal 2012-2014 për aprovim,

-pergatitja ë vendimit të bugjetit komunal 2012-2014 së bashku me formularët për të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimeve, dhe për të gjitha programet- nënprogramet sipas sistemit të BDMS-së,

-propozim vendimet dhe vendimet për ndryshim të bugjetit komunal,

-zotimi I fondeve për tetë drejtorate dhe tri zyre komunale sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve në numër prej 1.280 lëndëve,

Janë kryer edhe punë e detyra tjera sipas nevojës së programeve dhe kërkesës së Departamentit të Buxhetit pranë MF.

**2. Sektori I Thesarit.-** Në këtë Sektor punët dhe detyrat d punës në vitin 2011 janë kryer si vijon:

-pergatitja e pasqyrave financiare për vitin 2010,

-pergatitja ë pasqyrave financiare për përioden janar- shtator /011,

-pergatitja ë raportit financiar për vitin fiscal 2010,

-pergatitja ë raporteve mujore dhe përiodike financiare për të gjitha programet dhe nënprogramet sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve,

-perllogaritja e takses për transfer të pronës 95 lëndë,

-informimi iprogrameve -nenprogrameve për akordimin emjeteve financiare sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve,

-informatat në çdo kohë për gjendjen e shpenzimit të mjeteve financiare për të gjitha programet- nënë programet,

-kryerja e barazimeve mujore-periodike me departamentin e thesarit pranë MF, lidhdur me shpënzimet e bëra perms SIMFK-së,

-hartimi i raporteve mujore- përdiodike lidhur me të hyrat vetanake dhe barazimi në MF,

-kryerja e barazimeve lidhur me pagesat nënë 10,00 € dhe pranimi i ditarëve të arkës nga arkatari,

-regjistrimi i të gjitha të hyrave nga burimet vetanake sipas modulit përkatës në SIMFK, dhe barazimi sipas raporteve bankare ditore, mujore dhe përiodike,

-kryerja e barazimeve mujore me drejtoratet që arkëtojnë të hyra vetanake,

-kryerja e akordimeve për të hyrat vetanake sipas projekteve që financohen me të hyra vetanake,

-mbajtja e arkës lidhur me pagesat me para të gatshme nënë 100,00 €,

-lëshuarja e faturave për pagesat e qerasë për shfrytëzim të pasurisë komunale.

Janë kryer edhe punë tjera sipas nevojës së programeve dhe kërkesës së Departamentit të Thesarit në MF.

**3. Sektori I Financave.-** Në Sektorin e Financave gjatë vitit 2011, janë kryer këto punë dhe detyra punE:

-regjistrimi I shpenzimeve në SIMFK për të gjitha drejtoratet dhe zyret komunale, si dhe për të gjitha kategoritë kryesore ekonomike të shpenzimeve , numri i lendëve 2344,i krahasuar me një vitë më pare, shërbimet e kësaj natyre janë të rritura për +9,28%, apo 199 lëndë,

-është bërë çërtifikimi dhe aprovimi i 2.344 lëndëve të cilat janë dorëzuar në tërësi në arhivë për ruajtje,

-numëri i shërbimeve lidhur me arkëtimin e parave të imta për shërbimet në ofiqari ka qenë 14.914, në arhivë 3.470, gjeodezi , 3.580, tatim në pronë 784, shpallje të tenderëve 602, urbanizem 23, regjistrim të automjeteve 7.920- d.m.th. gjithsej: 31.293 shërbime, krahasuar me një vit më parë janë kryer 3.400 shërbime më shumë ,apo shprehur në përqindje +12,19%.

Edhe në Sektorin e Financave janë kryer punë dhe detyra të punës sipas nevojës së drejtorateve komunale dhe të MF-së.

**4. Zyra e Tatimit në Pronë.-**

Në vitin raportues nga kjo zyrë janë kryer këto punë dhe detyra pune:

-pergatitja ë bazës së të dhënave për faturim të 9.730 tatim paguesve për pasurinë epalujtshme,

-mbikqyrja ë shpërndarjes së faturave,

-përmirësimi manual i faturave të cilat janë përllogaritur në mënyrë të gabuar 222,

-pergatija për shpërndarje e 668 vërejtjeve të fundit për tatimpaguesit borgjëlinjë,

-shpërndarja në teren e 668 vërejtjeve të fundit,

-pranimi dhe ekzekutimi I aktvendimeve të bordit komunal të ankesave 72,

-mbledhjae të dhënave dhe përgatitja e tyre për futjen nërregulloren eTatimit në Pronë për vitin fiskal 2012,

- pergatitja ë rregullores së tatimit në pronë për vitin 2012,

-organizimi i ekipes anketuese në teren sipas kërkesave të qytetarëve,

-futja e të dhënave nga tereni në sistem kompjuterik për 303 objekte,

-regjistrimin ekontratave të shitblerjeve 253,

-përmirsimi iankesave me aktvendime 72,

-shlyerja e pagesave të bëra nga arka komunale 662,

-modifikimet për rastet e reja të pronave ,

-verifikimi i 222 objekteve të regjistruara,

-regjistrimi i 303 objekteve të reja,

-janë lëshuar 6.961 vërtetime për palë në lëminë e tatimit në pronë,

- printimi i 6.961 faturave në emër të shërbimit për qytetarët,

-janë kryer 6.760 shërbimeve lidhur me regjistrimin e automjeteve si pasuri e lujtshme,

-janë pranuar 66 ankesa në emer të përllogaritjes së tatimit në pronë.

Nga Zyra e Tatimit në pronë janë kryer edhe shumë punë dhe aktivitete pune me qëllim të ngritjes së pagesave në emer të obligimit të tatimit në pronë , fushë kjo e të hyrave nga burimet vetanake me më së shumti ndikim në bugjetin Komunal. Angazhimet e bëra nga Zyra e Tatimit në Pronë – DBF, lidhur me arritjen

e një shkalle të lakmueshme për arkëtim të tatimit në pronë, tregojnë kur bëjmë krahasimin e planifikimit të mjeteve për arkëtim nga kjo fushë prej: 141.177,00 € dhe arkëtimit të realizuar në shumë prej: 230.218,72 €, krahasim ky që paraqet tejkalim të objektivit për +63,07%.

**5. Masat e propozuara:**

Për të qenë sa më efikas në kryerjen e punëve dhe detyrave të punës , të cilat janë të parapara me Statutin Komunal, Ligjin për Menagjimin efinancave Publike dhe Përgjegjësitë, Rregulloret dhe vendimet në fuqi dhe programin e punës , DBF propozon këto masa:

-vazhdimin e vendosjes së numrave në objektet e palujtshme në tërë teritorin e Komunës së Drenasit,
-informimin e obliguesve të Tatimit në Pronë që t'i paraqesin ndryshimet eventuale në pronën e tyre siq janë: ndërtimi i shtëpive dhe objekteve tjera të reja, ndrrimi i destinimit të objekteve për mënyrën e shfrytëzimit, si dhe informimi për objektet e rrënuara,
-rritja e stafit në zyrën e Tatimit në Pronë,
-sigurimi i hapsirave të mjaftueshme për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës për punëtoret ë DBF,
-vazhdimi I aplikimit të masave për moskryerjen e disa sherbimeve komuale ndaj obliguesve tatimor,
-krijimi i mundësive për stimulimin epunëtorëve të dallueshëm në punë.

## Drejtorati për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit

Gjatë vitit 2011 në Drejtoratin për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit janë realizuar një numër i madhë i punëve gjdo herë duke u bazuar në rregulloret dhe ligjet në fuqi .

Sektori për planifikim u angazhua kryesisht me planet rregulluese dhe me këshillin e ekspertve në mënyrë që këto plane të jenë sa më funksionale dhe në përputhje me ligjin për planifikim, si dhe me planin zhvillimor Komunal po ashtu edhe në hartimin e projekteve ideore, për përgatitjen e paramasave dhe parallogarive të gjitha projekteve kapitale gjithëherë në përputhshmeri me udhëzimet administrative dhe ligjet në fuqi.

Sektori për leje ndërtimi bëri pranimin dhe shqyrtimin e të gjitha kërkesave duke u bazuar në ligjet në fuqi qoftë për kushte urbanistike, leje ndërtimi,caktime të lokacioneve, aktvendimeve. Po ashtu, është bërë mbikqyrja e punimeve si dhe pranimi teknik projekteve që kanë pasur të bëjnë me drejtorin e urbanizmit.

Sektori për Mbrojtje të Mjedisit punët dhe aktivitetet i ka kryer në bazë të programit të punës të hartuar nga ky sektor në kuadër të Drejtoratit për planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit. Në kuader të këtyre aktiviteteve është organizuar Tryezë e rrumbullekët Mbrojtja e Mjedisit – Përgjegjësi e të gjithëve për një mjedis më të pastër,por edhe për ngritjën e vetëdijës së qytetarëve që edhe ata të jenë pjesëmarrës në këto aksione dhe të kontribuojnë në përmirësimin e gjëndjës mjediosore. Në fillim të vitit 2011 është realizuar projekti për gjelbërimin e qytetit me fidane si dhe në parkun e Drenasit. Ne si komunë jemi përballur me probleme të shumta sidomos me ndotjën e mjedisit konkretisht me ndotjën e Ajrit të shkaktuar nga ndotësit më të mëdhenj siq janë: NEW CO "Feronikeli" dhe Guroret (përpunuesit e Gurit). Edhe pse me këta ndotës kemi pasur kontakte të vazhdueshme dhe kërkesa të njëpasnjëshme në mënyrë që të marrin masa për zvogëlimin e ndotjes këto kërkesa pothuajse nuk jenë përfillur pasiqë ende gjendjen e kemi të pa ndryshuar. Ne nuk kemi pasur mundësi për marrjën e masave ndaj këtyre ndotësve,sepse kompetent për marrjën e këtyre masave është MMPH-së.

Përveq shqyrtimit të kërkesave në këtë Drejtorat u hartuan edhe akte tjera ligjore në përputhëshmëri me Ligjet dhe rregulloret në fuqi si dhe në bashkpunim me Kuvendin Komunal nxori këto rregullore dhe vendime si:

Vendim për hartimin e planit lokal të veprimit në mjedis.
Hartimi i propozim vendimit për hatimin e Planeve Rregulluese për Qendrat 1,2 dhe 3 të Drenasit dhe Pokleku 3 me sipërfaqe prej 108.20 ha.
Vendimi për dhënjen me koncesion për mbindertimin e objekteve baneseore në blloqet II.III dhe IV.
Vendim për projektet që do të financohen nga Feronikeli.

Vendimi për dhënjen me koncesion për stacionin e Autobusve sipas modelit të PPP.
Vendimi për ndertimin e objekteve banesore në vendin e quajtur Ashanajka – Arat e ibrit.

Prandaj planifikimi i punëve për realizimin e projekteve kapitale per vitin 2011 që ishin paraparë me Vendim të KK të Drenasit kanë përfunduar dhe realizimi I këtyre projekteve kapitale ka ndikuar në masë të madhe në përmirësimin e infrastrukturës si në fshatra poashtu edhe në zonën urbane të Drenasit.
Të gjitha këto projekte u realizuan falë një bashkëpunimi shumë të mirë ndërmjet:
Komunitetit,komunës, Ministrive përkatëse si dhe donatorëve të ndryshëm që kanë ndihmuar realizimin e projekteve dhe përmisimin e jetës së qytetarve të Komunës sonë.
Gjatë kësaj periudhe një vjeqare në Drejtoratin për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambijentit janë parashtruar gjithësejt: 1,362.0 këkesa.
Si kërkesa për leje ndertimi ,kushte urbanistike,leje përdorimi,shëndrrime të lokaleve nga ato banesore në afariste,aktvendime për shfrytëzim të terasave,të banesave,vertetime, komisione për pranime teknike, komisione për mbikqyrje njoftime pëlqime.
Prej tyre janë:
Të pashqyrtuar: 6.0
Në proces: 189.0
Miratuar : 1109.0
Refuzuar : 37.0
Hedhur poshtë : 2.0
Pezulluar : 19.0
Totali : 1,362.0

Gjatë vitit 2011në drejtorin pë planifikim urban dhe mbrojtje të mjedisit janë lëshuar leje ndertimi 19.0, leje përdorimi 2.0, kushte urbanistike 29.0.

Që nga muaji Maji 2011 në Drejtoratin për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit u përgaditën të gjitha projektekt propozimet për projektet kapitale të komunës së Drenasit e që lista e këtyre projekteve pasi kaloi nëpër dëgjimet publike ju dërgua edhe komitetit për politikë dhe financa si dhe Kuvendit Komunal për caktimin e prioriteteve dhe miratimi i tyre për vitin 2011.
Të gjitha këto projekte i kemi dërguar në PIP- Sistemin sipas prioriteteve që ka caktuar Kuvendi komunal i Drenasit.
Kemi ndertuar fazen e parë të Deponis Tranzitore në bashkpunim me MMPH- në e cila do të kontribonte që Komuna e Drenasit të këtë një ambijent shumë më të pastërt, ku kjo deponi do të ndikojë drejtpërdrejt në krijimin e një ambijenti të pastër e cila deponi është projektuar dhe ndertuar sipas standareve dhe normave të Bashkimit Europian, ku për vitin 2012 presim të ndertoim edhe fazen e dytë të kësaj deponije .

Në vazhdim do të prezentojmë listen e projekteve kapitale për vitin 2011 :
Lista e projekteve kapitale të planifikuara si dhe të alokuara nga këto projekte.

| | **Emri i Projektit** | **Buxheti i Planifikuar** | **Buxheti i Alokuar** | **Buxheti i Shpenzuar %** |
|---|---|---|---|---|
| **1** | **Rregullimi I Kanalizimit në qytetin e Drenasit** | **4 000.00** | **4 000.00** | |
| **2** | **Ndertimi i Infrastruktures në L.Dëshmorve** | **30 000.00** | **30 000.00** | |
| **3** | **Asfaltimi i rrugës Abri Likovc** | **109 672,00** | **109 672,00** | |
| **4** | **Asfaltimi i rrugës Lagja e re Komoran** | **48 738,00** | **48 738,00** | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 5 | Asfaltimi i rrugës Lagja Zogu Komoran | 47 000,00 | 47 000,00 | |
| 6 | Kanalizimi L.I briqi dhe L.Nishori | 28 000,00 | 28 000,00 | |
| 7 | Ujsjellësi Drenas - Komoran bashkë financim me USAID-in | 90 000,00 | 90 000,00 | |
| 8 | Asfltimi i rrugës Baic | 129 000,00 | 129 000,00 | |
| 9 | Asfaltimi rrugës Krajkovë – Damanek | 123 804,00 | 123 804,00 | |
| 10 | Kanalizimi Terstenik L.Gashani | 18 000,00 | 18 000,00 | |
| 11 | Asfaltimi i rrugës L.Bytyqi Arllat | 94 000,00 | 94 000,00 | |
| 12 | Izolimi i Rezervuarit për Ujin e Pijes në Fshatin Bytyq | 8 000,00 | 8 000,00 | |
| 13 | Asfaltimi i rrugës në Vasilev | 170 000,00 | 170 000,00 | |
| 14 | Kanalizimi në Arllat L.Bujupi | 18 000,00 | 18 000,00 | |
| 15 | Kanalizimi Polluzh L.Istogu | 22 993,00 | 22 993,00 | |
| 16 | Asfaltimi i rrugës në fshatin Nikaj | 129 800,00 | 129 800,00 | |
| 17 | Asfaltimi i rrugës në fshatin Fushtic e Epërme | 37 000,00 | 37 000,00 | |
| 18 | Asfaltimi i rrugës në fshatin Gllobar | 123 000,00 | 123 000,00 | |
| 19 | Asfaltimi i rrugës Poklek i Vjetër | 47 228,00 | 47 228,00 | |
| 20 | Kanalizimi Poklek i Vjetër | 11 000,00 | 11 000,00 | |
| 21 | Kanalizimi në fshatin Krajkovë | 15 000,00 | 22 000,00 | |
| 22 | Asfaltimi i rrugës në fshatin Negrovc | 39 907,00 | 39 907,00 | |
| 23 | Asfaltimi i rrugës në fshatin Shtutic | 37 000,00 | 37 000,00 | |
| 24 | Asfaltimi i rrugës në fshain Gllanasellë | 126 200,00 | 126 200,00 | |
| 25 | Kanalizimi në fshatin Qikatovë | | | |
| 26 | Kanalizimi në fshatin Korrotic e Epërme | 27 000,00 | 27 000,00 | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 27 | Kanalizimi në fshatin Likoshan | 20 000,00 | 20 000,00 | |
| 28 | Rregullimi i pompave të ujit në fshatin Shtuticë | 9 500,00 | 9 500,00 | |
| 29 | Asfaltimi i rrugës në fshatin Dobrashevc | 88 000,00 | 88 000,00 | |
| 30 | Kanalizimi në Llapushnik | 36 000,00 | 36 000,00 | |
| 31 | Kanalizimi në Zabel të Ulët | 29 800,00 | 29 800,00 | |
| 32 | Kanalizimi në fshatin Terdevc | 37 000,00 | 37 000,00 | |
| 33 | Rezervuari në Kamenicë | 27 007,00 | 27 007,00 | |
| 34 | Ndertimi i shtëpive për skamnorë | 65 000,00 | 65 000,00 | |
| 35 | Hartimi i Planeve Rregulluese | 24 373,00 | 24 373,00 | |
| 36 | Mbikqyrja dhe Hartimi i Paramasave | | | |
| 37 | Ndertimi i Ures të Lagjet Cëravadiku,Bucolli,Rruku | | | |
| 38 | Mbikalimi në Dobrashevc | | | |
| 39 | Kanalizimi Korroticë e Ulët | 13 000,00 | 13 000,00 | |
| | Granti qeveritar | 1 871 022.00 | 1 813 870.89 | |
| | TOTALI I SHFRYTËZIMIT TË GRNDEVE 2011 | 1 871 022.00 | 1 813 870.89 | 96.94 % |
| 40 | Infrastruktura në L.Dëshmorve | 50 000.00 | 50 000.00 | |
| 41 | Asfaltimi i rrugës L.Heta, Hasi, Kuliqi | 62 000,00 | 62 000.00 | |
| 42 | Asfaltimi i rrugës Abri Likovc | 135 955,00 | 135 955.00 | |
| | Të Hyrat Vetanake 2011 | 247 955.00 | 136 893.68 | |
| | TOTALI I SHFRYTËZIMIT TË HYRAVE VETANAKE 2011 | | | 55.20 % |
| 43 | Ndertimi i rrugës L.Gjoka | 32 744,07 | 32 744.07 | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 44 | Ndertimi i kanalizimit në Drenasin -III- | 37 136,00 | 37 136.00 | |
| 45 | Ndertimi i kanalizimit L.Dvorani | 11 394,00 | 11 394,00 | |
| 46 | Rregullimi I kanalizimit qytetin e Drenasit | 24 208,86 | 24 208.86 | |
| 47 | Hapja e puseve për tri shkolla | 8 800,00 | 8 800.00 | |
| 48 | Rregullimi i zyreve të shoqatave të dalura nga lufta | 9 300,00 | 9 300.00 | |
| | Bartje Vetanake 2010 | 123 582.93 | 120 059.69 | |
| | TOTALI I SHFRYTËZIMIT TË BARTJEVE VETANAKE 2011 | | | 97.15% |
| | | | | |
| | | | | |
| TOTALI I BUXHETIT TË PLANIFIKUAR NGA GRANTI | 1 871 022.00 € | | | |
| TOTALI I BUXHETIT TË SHPENZUAR NGA GRANTI | | 1 813 870.89 € | | |
| TOTALI I MBETJEVE NGA GRANTI | | | 57 151.11€ | |
| | | | | |

**PËRQINDJA E SHFRYTËZIMIT TË GRANTEVE:** (Tsh / Tpl) x 100 (%)

**(1 813 870.89 / 1 871 022.00) x 100= 96.94 %**



| MJETET NGA MINISTRITË DHE DONACIONET | |
|---|---|
| MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPSINORË (MMPH) | 150,000.00 € |
| USAID | 90.000.00 € |
| MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL (MAPL) | 195.614.00 € |
| MINISTRIA E PUNËS DHE E MIRËQENJES SOCIALE (MPMS) | 166.300.00 € |
| MINISRTIA E INFRASTRUKTURËS | 97,815.85 € |
| KOMPANIA E UJSJELLËSIT RAJONAL PRISHTINA | 60,000.00 € |
| TOTALI I DONACIONEVE : | 759,729.85 € |

| GRUMBULLIMI I TË HYRAVE VETANAKE NGA DREJTORATI PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT PËR SECILIN MUAJ TË VITIT 2011 | |
|---|---|
| | |
| PLANIFIKIMI I TË HYRAVE VETANAKE PËR VITIN 2011 NGA DREJTORIA E URBANIZMIT | 60.665.00 € |
| | |
| TOTALI I TË HYRAVE NGA DREJTORIA E URBANIZMIT | 70,283.97 € |
| | |
| PËRQINDJA E REALIZIMIT TË HYRAVE NGA DREJTORIA E URBANIZMIT | (Dreal / Dpl) x 100 (%)<br><br>(70,283.97 / 60,665.00) x 100 = 115.86 % |

Të gjitha projektet të cilat kanë hyrë në listën prioritare nga Kuvendi Komunal presim që të realizohen me sukses ashtu siq është planifikuar nga Drejtorati për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.
Masat propozuese për kryerjen e projekteve të planifikuara për vitin 2012 dhe rekomandimet:

- Sigurimi i mjeteve vetanake për projekte kapitale të sigurohen brenda tremujorit të parë,
- Mjetet nga grantet qeveritare të alokohen në fillim të tremujorit të parë,
- Rishikimi i mjeteve për projektet kapitale të bëhet vetëm në gjashtë mujorin e parë.
- Të hulumtohen mjetet e planifikuara nga Ministritë për investime në Drenas
- Të ofrohen kushte për tërheqjen e donatorëve dhe krijimin e mundësive për investime të përbashkëta me komunitet, donatorë dhe Komuna,
- Të intensifikohet puna e inspekcionit të ndërtimit në teren,që të shtyhen ndërtuesit e objekteve pa leje ndërtimi që të kërkojnë legalizimin e objekteve të ndërtuara dhe shtytja për leje ndërtimi për ndërtime të reja.
- Të inicohet zhvillimi (hartimi) Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM).
- Të inicohet formimi i komisionit për mjedis në Asamblen Komunale.

## Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Në pajtim me nenin 17 pika f ,e **Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040,nenit 82 të statutit të Komunës,** si dhe në dispozitat e ligjit për **M**rojtje nga **Z**jarri,nr.**02/L-41** dhe ligjit për **M**brojtje nga **F**atëkeqësit **N**atyrore dhe **F**atkeqësit **T**jera,**nr.02/L-68**,përkatsisht nenit **31**,Drejtoria për **Shërbime Publike dhe Emergjencë**,gjatë të vitit 2011,është angazhuar që të realizojë punët dhe detyrat që kan qenë të parapara me planin dhe programin e punës së këtij drejtorati.

**Hyrje**

Në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë punojnë:

- Drejtori,
- Shefi për Shërbime Publike dhe Planifikim,
- Zyrtari për Mbrojtje dhe shpetim,
- Zyrtari për furnizim me ujë menagjim të mbeturinave dhe Kanalizimit dhe ujrave të zeza dhe atmosferik,
- Zyrtari për arhivë dhe mirëmbajtje të dokumentacionit
- Në kuadër të kësaj drejtorie funksionon edhe Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Shpëtimit në kuadër të të cilit punojnë,Shefi i njësisë së SHZSH,katër shofer dhe 11 Zjarrfikës.

**Organogrami i Drejtoratit për Shërbime Publike dhe Emergjencë**



Forma e veprimit të Drejtorisë është në funksion të shërbimit të të gjithë qytetarëve të Komunës sonë,ku paraqet esencën e zbatimit të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale në Komuna dhe të Statutit të ri të Komunës për të gjithë sektorët.

Prandaj, në bazë të dëtyrave të parapara me Statutin e Komunës dhe të atyre të paparapara , por të afatizuara të zyrës dhe të terrenit me qëllim të mbrojtjes së popullatës në Komunën tonë ndaj Emërgjencave civile dhe fatkeqësive elementare dhe kryrjen më cilësore të shërbimeve publike për qytetaret ,atëher punët dhe detyrat e kësaj drejtorie janë kryer më sa vijon:

## Koordinimi i punës dhe operativa

Në kuadër të punëve dhe të dëtyrave që janë në sektorin e MSH përkatësishtë të planifikimit dhe operatives janë kryer:

- Hartimi i planit-Vlerësimi i Rrezikut në teritorin e Komunës,

- Jemi në proceduren e hartimit të planeve për Reagim Emergjent

- Plotësimi i Profilit të Komunës.

- Hartimi i Programit të aktiviteteve në zbatimin e masave të posaqme të mbrojtjes nga zjarri në territorin e Komunës së Drenasit.

- Punimi dhe planifikimi i punëve të terenit dhe të zyrës

- Përpilimi i informatave periodike dhe raporteve mujore të punës për Agjensionin e Menaxhimit të Emergjencave të Kosovës lidhur me numrin e intervenimeve dhe me ecurinë dhe problematikën e punës profesionale,dhe plotësimi I formularit për krijimin data bazës për pasijet dhe përsonelin teknik që do të marrin pjesë në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.

- Përcjellja dhe zbatimi i ligjit dhe të akteve tjera nga kjo lëmi,

- Mbajtja e konsultave në nivel të ekspertëve në kuadër të drejtorisë dhe të Departamentit të menagjimit të emërgjencave në nivel qendror.

- Pjesë marrja në aktivitete për rritjen e përformancës së shërbimeve publike në nivel komonal,përkatësisht me GTZ-në ku pritet përfitimi I një donacioni për projektin e riciklimit të mbeturinave në nivel të regjionit të Prishtinës,nga Bashkimi Evropian.

- Zhvillimi I aktiviteteve për përfitimin e donacionit për Projektin e Ndërtimit të Deponis tranzite,me MInistria e Planifimit Hapsinor,ku është kjo deponi është lëshuar në funksion nga Kompania ‘’Pastrimi’’,në bashkëpunim me DSHPE-në

- Hartimi I kornizës bugjetore(Kërkesave fillestare),për vitet- 2011-2013,

- Hartimi I planit të punës për vitin 2012 për DSHPE-në,

- Hartimi I draft Rregullorës për menagjim të mbeturinave për teritorrin e Komunës së Drenasit,

- Fillimi I hartimit për Projekt-Planin për menagjimin e mbeturinave në bashkëpunim me GIZ-in Gjerman,

- Hartimi I paramasave dhe parallogarive për projektet kapitale,

- Hartimi I raporteve të vlerësimit të dëmeve të shaktuara nga zjarret,dhe fatkeqësit tjera elementare.

## Pjesmarrja aktive në rastet e fatëkeqësivë (zjarreve, vershimeve)

Gjatë vitit 2011,shërbimi i zjarrëfikësve dhe shpëtimit të Komunës sonë është përballur me shuarjen e:

- **331 zjarreve,**
- **85 - shërbime tjera** si pastrime pusesh të cilat kanë qenë të ndotura nga reshjet e shiut,dhe shërbime tjera si vendosja e panove dhe flamujve për ditëm e Çlirimit të Komunës sonë dhe festive tjera etj.
- **8- Aksidente në komonikacon rrugor**,ku prej këtyre rasteve ka pasur edhe të lënduar.
- **6- Intervenime gjatë vërshimeve.**

**Vlenë të përmendet se janë ndihmuar nga kategoria e subvencioneve –transfereve,disa familje të cilat kan pësuar dëme nga zjarret,vërshimet dhe fatkeqësit tjera elementare.**

**Vlenë** të përmendet së të gjitha këto shërbime janë kryer me shumë vështirsi për shkak të automjeteve tejet të vjetruara që ka në disponim SHZSH-ja,të cilat janë gati jashtë përdorimit.

## Zhvillimi i aktivitetetеve sektorin për Shërbime Publike

Aktivitet për Shëbimet Publike janë të shumta dhe ne do të specifikojm ato punë dhe shërbime qe jemi munduar që ti kryejm në mënyren me të mirë të mundëshme.

Kemi mirëmbajtur Ndriqimin Publik të rrugëve të komunës së Drenasit me gjatësi rreth 8 km,po ashtu të sheshit”Fehmi Lladrovci”dhe parkut.

**Kemi kryer projektin për mirëmbajtje të gjelbrimit dhe drunjëve dekorativ në sheshin dhe parkun e qyetetit.**

**Gjithë ashtu kemi bërë edhe ndiqimin dhe dekorimin e sheshit ‘’Fehmi Lladrovci’’për festat e vitit të Ri.**

## Njësia për transport

Në këtë njësi janë zhvilluar kryesishtë aktivitete rrethë dhenjëve të lejeve të operimit për transport të udhëtarve për të gjitha kategorive,prandaj në bazë të **shenimeve që kemi në dispozicon në Komunëne tonë ekzistojnë:**

A. **72-** ***Taxi-shërbime të regjistruara në MTI,ku prej tyre:***

a) **46-*Kombi-Taxi,***

b) **21-*Auto-Taxi,***

c) **5-** ***Ndërrmarrje për transport të udhëtarve(NTU) të regjistruara në MTI.***

Më poshtë do ti paraqesim në mënyrë tabelare dhe grafike përqindjen e realizimit për leje operimi për të gjitha kategorit e transportuesve,të cilët kanë bërë kërkesë për të.

| NNr | Lloji i transportuesve | Që kanë aplikuar për leje Operimi | Të pajisur me leje operimi | Që nuk kanë leje operimi | Përqindja e realizimit |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kombi-Taxi | 46 | **43** | **3** | 93.4 % |
| 2 | Auto-Taxi | 21 | 14 | **7** | 66.6 % |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Ndërrmarrje të transportit Lokal (Autobusë) | **5** | **4** | **1** | **80 %** |
| 5<br>5 | Gjithësejt | 72 | 61 | 11 | 84.7% |




Siqë po shihet nga tabela përqindja e realizimit për leje pune nuk është e kënaqëshme, edhe pse të gjjithë të intersuarit që kanë bërë kërkesë janë të pajisur me leje pune,pos atyre që nuk i kan plotësuar kushtet sipas kritereve që kërkohen me ligj dhe Rregullores Komunale për komonikacion rrugor.Po ashtu një numer i konsiderushem i Autobusve dhe kombitaksive kan punur pa leje operimi,prandaj duhet që në këtë drejtim të punoj me tepër Inspektori Komonikacionit,në mënyrë që të përmirsohen rendi dhe qarkullimi në komonikacion.

**Kemi përfunduar projektin për shenjëzimin vertikal dhe horizontal** të rrugëve të qytetit dhe rrugëve lokale të asfaltuara .ku jemi përqendruar kyesisht në vendosjen e shenjave për ndalim të detyrushëm në dalje të rrugëve lokale të asfaltuara të fshatrave po ashtu vendosjen e policëve të shtrir ,zebrave për kalim të udhëtarëve dhe shenja tjera që kanë qenë të domosdoshme për qarkullim normal të komonikacionit.

Është përfunduar **projekti i Renovimit të gropave në rrugët të asfaltuara si dhe mirëmbajtja e rrugëve të rendit të IV me zhavor.**

**Jemi në vazhdimësi të mirëmbajtjes,pastrimit dhe kryposjen 195 km të rrugëve nga bora në komunën e Drenasit,ku kompania është duke i pastruar me të gjitha kapacitet që ka në dispozicion.**

**Njësia për furnizim me ujë dhe menagjim të mbeturinave dhe mirëmbajtje të kanalizimit**

Aktivitetetet drejtorisë për SHP&E-cë për bashkëpunim me Njësit për furnizim me Ujë dhe Njësin ‘’PastrimI’’ që mirret me menagjimin e mbeturinave nuk kanë munguar edhe për këtë vit. Ne si Drejtorat kemi nxjerr edhe urëdhëresen për mbjatjen nën kontroll të shpënzimit të ujit të pishëm dhe shfrytzimin sa me racional të tijë gjatë përiudhës kohore prej (02.06.-15.10.)2011. Mirëpo pas fillimit të temperaturave të larta ka pasur edhe reduktime të furnizimit me ujë, si rezultat i keqëprdorimit,prandaj kjo kompani ka përpiluar edhe orarin për reduktimet e mundëshme, për përiudhen kur rritet nevoja për shpenzimin me ujë.
Në bashkëpunim me Njësin e kompanis ‘’Pastrimi’’,kemi lëshuar në funksion Deponin tranzite të mbeturinave,ku prej aty mbeturinat barten në deponin kryesore.
Kemi përfunduar **projektin për mirëmbajten e kanalizimit atmosferik dhe pastrimin e gropave septike**,si dhe projektin e largimit të deponive të egra në disa vende si të Quka në Komoran,rrugës për Gradicë si dhe vende tjera.
Po ashtu kemi aplikuar se bashku me komunat e regjionit të Prishtinës në Bashkimin Evropian për përfitimin e donacionit për Riciklimin dhe ndarjen e mbeturinave dhe procedura është në përfundim e sipër.Nga ky projekt do të përfitoj shumë edhe komuna e jonë sepse do të përfitojn separi vete qytetaret si dhe punësimi i një numri të punëtorve në kompanin ‘’Pastrimi’’.

## Bashkëpunimi i DSHP&E-cë me subjektet tjera

DSHP&E-cë si organ në kuadër të Kuvendit Komunal,veprimtarinë e vet e zhvillon në bashkëpunim të përherëshem me drejtoritë e organeve të administratës,veqanërisht me Drejtorinë për Urbanizem dhe Planifikim Hapsinor,Drejtorinë për Financa dhe Ekonomi,Drejtorinë për Arsim dhe Kulturë,Drejtorinë për Shendetësi dhe Mirëqenje Sociale,Drejtorinë për inspeksion,Policin e Kosovës.

**Duke u bazuar në Planin dhe programin e punës për arsimimin dhe ngritjen profesionale të përsonelit në situatat e Gadishmërisë Emërgjente kjo drejtori ka bashkpunim të mirë me “**Qendren Nacionale për Siguri,Edukim dhe Zhvillim**”në Vushtrri ku edhe gjatë këtij viti në këtë Qendër janë trajnuar dhe çertifikuar për zjarrfikës profesionist dhe menagjim të vijës së parë, disa zjarrfikës të Brigadës së SHZSH .**

## Objektivat për vitin 2012

**Objektivat që synojm ti realizojm për këtë vitë janë:**

- **Rritja e cilësis së shërbimeve komunale duke filluar prej menagjimit të mbeturinave,ujrave,kanalaizimit etj.**
- **Rritjen cilësis për mirëmbajtje të ndriçimit publik,**
- **Rritjen e cilësisë së mirëmbajtjes se rrugëve të aflatuara dhe rrugëve të rendit të IV,**
- **Rritjen e cilësis së shërbimeve në eliminimin e deponive të egra,dhe futjen në sistem të komunitetit për pagesë për ujë dhe mbeturina**
- **Rritjen e të hyrave vetanake nga taksat e bizneseve për reklama dhe shfrytzim të hapsirave publike(parkingjeve) etj.**

## P ë r f u n d i m

Në bazë të gjendjes së parashtruar me anë të këtij raporti të punës,e në bazë të vëllimit,ndërlikushmerisë dhe të llojllojëshmërisë së punëve dhe detyrave të punës,mund të konkludohet së janë kryer punë dhe detyra të punës në sasi dhe cilësi.Kjo është arritur,duke patur parasysh angazhimin e tërë përsonelit në nivel të Drejtorisë dhe SHZSH-së,përkundër veshtërsive që kemi pasur gjatë realizimit të tyre.

## Drejtorati për Kadastër,Gjeodezi dhe Pronë

Hyrja- përgjegjësit dhe kmpetencat

Kjo Drejtori kryen një veprimtari specifike, profesionale të punëve dhe detyrave të punës me interes të përgjithshëm të qytetarëve, personave civil –juridik. Mban evidencën e të gjitha Tokave të Komunës së Drenasit të ndarë në 35 zona kadastrale, lidhjen e Hipotekave dhe Regjistrit të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme kadastri etazh,kadastri nentokesor etj.

Organizimi i mbrendeshem

Sektori i kadastrit ,

Sektori i gjeodezis .

Sektori i mardhanjeve pronësoro- juridike.

Të Hyrat

Si Drejtori Komunale arkëton të hyra publike për mes instrumentit financiar ,taksa, matje gjeodezike , si kundër vlere e shërbimeve të kryera për personat fizik-juridik .

Nga të hyrat e burimeve vetanake , Drejtorati për kadastër merr pjesë si fushë kryesore e të hyrave e cila fushë ka qenë e planifikuar për të arkëtuar të hyra në shumë prej : 31.000 € në raport me planin realizimi është tejkalu 277.68 % për faktin se gjendja e të hyrave me 31.12.2011 ka qenë në shumë prej 86.081 € ; në qoftë se këtë shumë e krahasojmë me bugjetin e planifikuar përqindja ndaj planit është 277.68 %

PUNËT E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE

- Kërkesa të terrenit.
- Hipoteka
- Certifikata mbi gjendjen ekonomike
- Ekstrakte nga fletë posedimet dhe k. Plani
- Lëndë të ndryshme nga pronësia

- Fl. pos dhe kopje Plani të pas. Shoqërore
- Lënda për drejtorinë e urbanizmit
- Akte tjera të ndryshme nga gjykata
- Akte të drejtorisë

Për realizimin e projekteve nga Komuna e Drenasit në mungesë të pronave kemi pasur vështirësi nga se vendet me atraktive (pronat) për realizimin e projekteve i menaxhon AKP-ja në Prishtinë andaj kjo Drejtori disa herë ka kërkuar nga AKP-ja pronë qoftë edhe më ndërrim, vetëm mos të dështojnë projektet e ndryshme për shkak te pronës p.sh. për Zonën industriale është kërkuar nga AKP-ja që të hiqet nga privatizimi një pjesë e ngastrave kadastrale në sipërfaqe prej 97 hektarësh në Korroticë e Lartë –Sankoc. Gjithashtu edhe për lagjen banimore te ferronikelit kemi bere terkes pran AKP autoritet per menaxhimin dhe shitjen e pronave shoqërore ,qe te lejohet regjistrimi ne emër te komunës se Drenasit,e pasandej me p[propozim] te Kryetarit të komunës kuvendi i komunës te vendos për çështjet pronësoro –juridike te kësaj lagjeje.

Bashkëpunimi i drejtorisë me organe dhe subjekte të tjera të Komunës.

Në kuadër kompetencës së vet teknike profesionale dhe administrative, punën e vetë e kryen në bashkëpunim të ngushtë dhe të përhershëm me kryetarin ekomunes , Kuvendin dhe Agjencia e Kadastrale të Kosovës.

- Gjatë kësaj periudhe është me rëndësi të theksohet se Drejtoria ka qenë e angazhuar në programin Tatimi në Pronë të gjitha punët e terrenit që janë formuar komisioni komunal për ankesat e parashtruara .
- Në Bordin e ankesave për tatimin në pronë janë vendosur 72 ankesa të palëve të ndryshëm, njeri anëtar është nga kjo Drejtori.
- Me Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit për të gjitha projektet punët gjeodezike janë kryer nga punëtoret e kësaj Drejtorie , sidomos me rastin e ndërtimit të rrugëve Lokale në përkufizimin e tyre .

Sektori i Gjeodezisë

Sipas kërkesave të palëve të ndryshëm Sektori për Gjeodezi ka pasur 181 kërkesë me natyrën e ndryshme si përcaktimi i kufijve , ndarje të cilat janë shqyrtuar në afatin ligjor .

Vështirësitë për këto kërkesa kanë qenë sepse shumë herë është dashtë të konsultohemi me

| |
|---|
| agjencionin Kadastal duke kërkuar ndihmë profesionale e pas marrjes së konfirmimit kemi kryer matjet dhe vendosjen Ligjore . Krahasuar nga vitet e mëparshme kërkesat në këtë vit kanë qenë për 30% më shumë se viti paraprak.<br>Vëllimi i punëve këtë vit në këtë sektor ka qenë më i madh për 531 raste nga fakti se janë bërë regjistrime në librat kadastral (Fletëparaqitje ) ku i janë përcjellë sektorit të Kadastrit për regjistrim të mëtutjeshëm në RDPP<br>Me administratorët e fshatrave dhe të bashkësive lokale rreth çështjeve të uzurpimeve të sipërfaqeve publike dhe të rrugëve lokale, në dhënien e informacioneve dhe konstatimin e gjendjes faktike në terren gjithsej 18 raste |
| Sektori i Pronës<br><br>Për përudhën raportuese , gjegjësisht nga janari I vitit 2011 e gjerë në përfundim të viti 2011 nga sektori për mardhënjeve pronësore – juridike janë kryer-realizuar detyrat e punës sipas akteve normative të Drejtoratit për kadastër,gjeodezi dhe prone të KK Gllogocit dhe sipas kërkesave të parashtruara nga palët , e gjithashtu edhe sipas detyrës zyrtare (ex ofcio) dhe atë:<br><br>-Shqyrtimi marrdhënjeve pronësore -juridike (uzurpimet e pronës komunale) 20 raste<br>nga të cilat janë shpall uzurpues 9 raste prej tyre për 5 uzurpues pas plotfuqishmërisë se aktvendimeve janë venë edhe klauzolat për nxjerrje të konluzjoneve në inspeksionin e KK Gllogocit për ekzekutim të aktvendimeve e po ashtu edhe nga avokati publik janë bërë kallëzimet penale për ata uzurpator.<br><br>-Për përkufizim të rrugëve publike janë përfunduar dhe zgjedhur çështjet për 15 raste. Prej tyre 6 raste në rajonin komasativ. Në këto kërkesa kemi arrit që të I zgjedhim çështjet kontestuese për rrugë në mes të palëve në fshatrat e komunës aty ku janë paraqit kërkesat e domosdoshme (do të thotë është bërë aktpajtimi në mes tyre).<br><br>-Është punuar në komisionin për vlerësim të dëmtimit të pronave gjatë vendosjes se trasesë se tensionit të lartë nga Feronikeli e gjerë te parku I biznesit në K. te epërme ,ku janë arrit dhe nënshkruar 80 marrëveshje ne mes të pronarëve dhe përfaqësuesve te KEK-ut.<br><br>-Janë lëshuar 56 vërtetime që Komuna nuk është e interesuar me blerë pronat shitësve dhe janë lëshuar edhe 56 vërtetime që pronat e shitura nga personat fizik nuk kanë qenë të nacionalizuara.<br>-Janë kryer edhe punë tjera me interes për Drejtoratin për kadastër,gjeodezi dhe prone dhe Komunën e Gllogocit. |
| Punët administrative,<br><br>Gjatë vitit raportues edhe ky Sektor ka qenë më i ngarkuar shume se vitet e mëparshme për shkak se kemi bërë regjistrimin në RDPP të 531 troje të Lagjes së Dëshmorëve. .Kërkesa për subvencionim nga Ministria e Bujqësisë si dhe me rastin e shpronësimit të tokave të qytetarëve të komunës sonë nga |

Qeveria për Autostradë ku janë lëshuar dokumentacion kadastral të cilat do ti paraqesim në mënyrë tabelore më poshtë,

Pasqyra Tabelore e Akteve zyrtare administrative-juridike të lëshuara nga Drejtoria për kadastër gjeodezi dhe Pronë për vitin 2011.

| Aktet | Numri |
|---|---|
| Akte të shitblerjeve | 65 |
| Regjistrimi i parcelave | 93 |
| Lidhje Hipoteke | 96 |
| Fshirje Hipoteke | 32 |
| Ndarje Parcelash | 586 |
| Çerambajtje për 99 vite | 23 |
| Certifikata mbi gjendjen ekonomike | 4173 |
| Ekstrakte nga Fletë posedimi dhe k. Plani | 1870 |
| Lëndë të ndryshme nga pronësia | 136 |
| Gjithsejtë: | 7074 |

Gjithsejtë për vitin 2011 janë të kryera : 586 ndërrime kadastrale

1) Bartja e lëndëve për regjistrim , ndërrim ,trashëgimi, apo të drejtën mbi paluajtshmërinë gjithsejtë 949

përfundim

Çështja e komasacionit ri matjeve dhe kontestet pronësore te mbetura qe nga vitet 1985 , si dhe kadastra e etazheve kane qene shume te nevojshme për komunën tone.

Sipas informatave zyrtare,,ne vitin 2012, Agjencioni kadastral i Kosovës, me financim nga banka botërore do ta financoj projektin e kadastrit etazh ,ndërsa Ministria e bujqësisë gjithashtu te financuara nga Banka botërore do te financoj projektin e ri matjeve te tokave qe

janë te përfshira ne komasacion për komunën e Drenasit ,shpresojmë qe kësaj radhe do te kryhet një pune e mire për komunën tone dhe qytetaret ne zgjidhjen e çështjeve pronësore,te mbetura qe [3] tri dekada.

**Drejtorati i Inspektimit Komunal**

Gjatë periudhes janar-dhjetor 2011 përpara kësaj Drejtorie dhe Inspektorëve të saj janë paraqitur sfidat e ballafaqimit për të zbatuar gjithë rregullativen ligjore në mbrojtje të qytetarëve.

Anadj kjo Drejtori duke u bazuar në planin operativ të punës për vitin 2011, Ligjet e Kuvendit të Republikes së Kosoves, Udhëzimet Administrative,Rregulloret Komunale si dhe Statutit të Komunës, punët dhe detyrat e punës i ka kryer sipas lëmive inspektuese.

Po ashtu kjo Drejtori gjatë tërë vitit ka qenë mjaft transparente me qytetarë, për të gjitha problemet dhe kërkesat e tyre, gjithnjë duke respektuar Kodin e mirësjelljes në raport me qytetarët.
Megjithë vështirësitë që kishte kjo Drejtori, si psh. përballjen dhe pengesat e mëdha dhe të llojllojshme, Drejtoria e Inspeksionit ka qenë këmbëngulse në zbatimin e ligjeve të aplikueshme dhe vendimeve të pushtetit lokal.

*Mënyra e menagjimit në këtë Drejtori ka qenë në nivel të aktiviteteve të rëndësishme varësisht prej punës dhe detyrave të punës se a kanë qenë ato rutinore, operative apo strategjike.*

*Kështu që për punët rutinore dhe operative sipas udhëzimeve administrative, kryerja e punëve dhe detyrave të punës ka rrjedh sipas modelit të vendosjes individuale, ku secili inspektor ka qenë i pavarur për punën e tij në punet rutinore konform ligjeve të aplikueshme dhe rregulloreve në fuqi, për punët që menagjon në lëminë përkatse inspektuese. Për punët dhe detyrat e punës të nivelit më të lartë menagjerik, ku janë kërkuar zbatimet e vendimeve strategjike si model ka qenë puna grupore dhe kolektive e inspektorëve.*

*Por, çdo herë në procesin e modelit të vendosjes është aplikuar parimi i identifikimit të problemit, parimi i efikasitetit, vlerësimi i alternativave, zgjedhja e alternatives më të mirë, zbatimi i vendimit dhe gjerë të kontrolla e implementimit të vendimit. Kjo është aplikuar sidomos në zbatimin e vendimeve strategjike në kushte të rrezikut.*

***Kryerja e punëve dhe detyrave të punës***

*Drejtoria e Inspeksionit disponon gjithsejtë me nëntë punëtor, në të gjitha lëmitë inspektuese ka qenë mjaft aktive me gjithë problemet e mëdha që rendojnë këtë trevë.*
*Në fakt, në këtë Drejtori punojnë dhe veprojnë Shefi i Inspeksionit dhe 7 inspektorë të lemive të ndryshme inspektuese.*

*Inspektorët e Drejtorisë se Inpeksionit gjatë kësaj periode raportuese kanë vazhduar më vendosmëri zbatimin e Ligjeve, Vendimeve dhe Rregulloreve të Komunës së Drenasit. Natyrisht se gjatë kësaj periudhe edhe vështirësitë kanë qenë evidente, ku rëndësi e veqant iu është dhënë kërkesave të qytetarëve për problemet e tyre. Mirëpo përkundër kësaj kjo Drejtori ka arritë që të vëjë nën kontrollë subjektet që iu nënshtrohen inspektimeve si dhe ka marrë masa të menjanimit të shumë parregullësive gjithnjë në përputhje me ligjet në fuqi.*

*Kështu që gjatë periudhes janar-dhjetor 2011 janë kryer punët dhe detyrat në mbikqyerjet inspektuese si vijon:*

*-Inspektimi në lëminë e ndërtimtarisë dhe zbatimit të planeve urbanistike, shërbimeve komunale-banesore dhe të infrastrukturës,*

*-Inspektimi në lëminë e tregut dhe mbrojtjen e konsumatorit,*
*-Inspektimi në lëminë e bujqësisë dhe pylltarisë,*
*-Inspektimi në lëminë e mbrojtjes së ambientit,*
*-Inspektim në lëminë e shëndetsisë dhe mbikqyrja sanitaro- higjenike,*
*-Inspektimi në lëminë e komunikacionit rrugor,*
*-Inspektimet tjera sipas kërkesave dhe dispozitave të veçanta.*

*Ndonëse është kryer një punë e madhe, parregullsitë që mbreterojnë kërkojnë angazhim edhe më të madh e sidomos në luftimin e Ekonomisë joformale, parandalimin e ndertimeve pa leje,mirëmbajtjen e pastertisë në Komunen e Drenasit etj.*

*Gjatë kësaj periudhe janë përcjellur ndërtimet pa leje dhe janë marrë masat e parandalimit të kësaj dukurie që vazhdon të mbetët preokupim i kësaj Drejtorie, janë vënë në mbikqyrje shumica e lokaleve te konsumit të gjerë, shendeti publik i qytetarëve si dhe konfiskim malli me afat të skaduar. Poashtu është mbikqyrë edhe mirëmbajtja e pastërtisë në territorin e Komunës, ku problem me vete kanë qenë ujërat e zeza sidomos në pjesët rurale dhe në vendbanimet ku mungon kanalizimi. Është bërë kontrollë përmamente e trafikut urban dhe periferik.*

*Nder qeshtjet kryesore ka qenë dhe mbetet kontrolli dhe inspektimi i New Co Feronikeli Complex L.L.C. në Drenas si ndotësi më i madh i ambientit në teritorin e Komunes sonë.*

*Për të gjitha parregullsitë është mbajtur evidence përkatëse, ndërsa ndaj shkelësve të ligjit janë parashtruar kërkesat në gjykatë varësisht nga natyra e veprës. Gjatë tërë vitit kemi pasur bashkëpunim me Policinë e Kosoves Njesiti në Drenas.*

*Gjatë periudhes raportuese janar-dhjetor 2011 janë bërë gjithsejtë:*
*-Procesverbale.....................................933*
*-Aktvendime.......................................145*
*-Fletëparaqitje.......................................65*
*-Mbyllje të lokaleve .............................16*
*-Pëlqime sanitare...................................60*
*-Konfiskim malli..................................699.35 €*
*-Denime mandatore..............................360.00 €*

**Nga lëmia e Inspeksionit të tregut**

Në këtë lëmi janë të angazhuar tre inspektorë ku është bërë inspektimi dhe mbikëqyrja e subjekteve ekonomike tregëtare dhe shërbyese në kontrollimin dhe verifikimin e zbatimit të dispozitave ligjore dhe nënëligjore me qëllim të eliminimit të praktikave të pa drejta tregëtare, mbrojtjës cilësore të interesave ekonomike të konsumatorëve dhe vendosjes së rregullave në tregun e brendshëm.

Në ketë drejtim rëndësi më e madhe i është kushtuar paisjes së subjekteve afariste me leje pune gjerë kah mesi i muajit korrik 2011, kur ka hyrë në fuqi Ligji nr.04/L-005 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.2004/18 Për Tregëtinë e Brendshme ku edhe janë hequr lejet e punes, në fakt kjo ka ndikuar që shumë subjekte afariste të iu shmangën obligimeve financiare si taksave komunale dhe tatimit në pronë që kanë qenë si kritere për t'u paisur me leje pune.Prandaj në Komunen tonë është mëse e nevojshme të kemi edhe një Inspektorë Financiar për grumbullimin e e mjeteve vetanake financiare, ashtu siç është e rregulluar në shumicën e Komunave të Kosoves, ngase Inspektorët e Tregut nuk kanë bazë ligjore për zhvillimin e procedurave në lëminë e grumbullimit të mbledhjes së taksave komunale.

Vlenë të theksohet se inspektimet shpeshëherë janë bërë edhe gjatë natës dhe është vërtetuar se nuk ka shumë lokale që vazhdojnë punen pas orarit të caktuar të punes, të caktuar nga Drejtoria e Ekonimisë dhe Bujqësisë.

Në vazhdimësi nga inspektorët e tregut janë kontrolluar subjektet afariste treëgare dhe shërbyese se a janë të regjistruara dhe të paisura me Çertifikata për Regjistrimin e Biznesit, respektimin e orarit të punës, vendosjen e qmimeve të produkteve, mbrojtjen e konsumatorit etj. Nga Inspektoret e tregut është punuar në zbatimin e “Strategjisë për Luftimin e Ekonomisë Joformale” si kontrollimin e Agjensive Turistike, Pompave të Derivateve, se a janë të paisura me Licencë të nevojshme që i lëshon MTI-ja.

Poashtu nga Inspektorët e tregut janë mbikëqyrë përdorimi i peshoreve dhe njësive matëse në treg, siguria dhe përshtatëshmëria e produkteve në treg, etiketimi dhe deklaracioni i mallit, tregjet javore etj.

Edhepse sipas Ligjeve të lartëpërmendura më lartë mjaftë mirë është e përcaktuar që pranimin teknik dhe të lokaleve afariste për plotësimin e kushteve mininale higjeniko-teknike ta bej Inspektoriati, ketë detyrë e kryen komisioni i veçant e që është në kundërshtim të plotë me këto Ligje dhe Udhëzimet Administrative.Inspektorët e Tregut në bashkpunim me Inspektorët e lëmive të tjera që nga 25 korriku 2011 kanë qenë te angazhuar në zbatimin e vendimit të parimit të reciprocitetit ndaj mallrave të Serbisë dhe Bosnje-Hercegovines deri në shfuqizimin e këtij vendimi.

Inspektoriati i tregut shpeshëherë është ballafaquar edhe me shumë probleme të natyrave të ndryshme siq është rasti i mbylljes së përkohëshme i një lokali afarist përshkak të konfliktit në mes të dy palëve. Në fakt ky ka qenë kontest civil në kompetencë të Gjykatës Komunale, ku njëra palë ka ushtruar padi ndaj Drejtorisë për Inspeksion, por, Gjykata Komunale në Drenas e ka hedhur posht ketë dhe e ka vertetuar si të arsyeshëm veprimin e Drejtorisë për Inspeksion.

**Raporti i punes në shifra:**

-Procesverbale.............................367
-Aktvendime.................................15
-Mbyllje të lokaleve......................16

**Nga lëmia e Inspeksionit të Ndertimit**

Ballafaqimet më të mëdha të Drejtorisë së Inspeksionit gjatë vitit 2011 kanë qenë nga lëmia e ndërtimit. Prioritet kryesor i punës inspektuese ka qenë parandalimi i ndertimeve pa leje me qellim të ruajtjës së pronës shoqërore dhe komunale sidomos në Drenas dhe Komoran. Gjatë kryerjes së punëve dhe detyrave të punes nga kjo lëmi përveq arritjes së objektivave jo dhe aq të dëshiruara ka pasur pengesa të natyrës objektive dhe subjektive e të cilat janë:
-qështja e ndërtimeve në zonat e komesacionit është problem në vete në lëminë e ndërtimit ngase kjo me vite nuk ka ndryshuar, ndërkaq pronat janë private dhe njerëzit ato i shfrytëzojnë për ndërtim.
-shtytje ju ka dhënë edhe ndërtimi i Autostrades Vërmicë-Merdar e që kalon nëpër Komunen tonë ku shumë nga qytetarët kanë pretenduar të ndërtojnë objekte për rreth kësaj rruge.

Përballja me mbindertimet ka qenë si pasojë e ndertimeve të vjetra të objekteve banesore dhe depertimi i të reshurave ku si shtytje ka qenë edhe mos realizimi i projektit të miratuar nga Komuna për mbindertime me qellim të izolimit, ndersa në Lagjen e Re në Komoran dihet që pas lufte janë bërë ndërtime pa leje, gjersa gjatë këtij viti kemi arritur që palët ta ndalin vrullin e ndërtimeve pa leje edhe pse Inspektorët e kësaj Drejtorie shpesh kanë qenë të rrezikuar edhe fizikisht.Gjatë vitit 2011shpeshëherë kemi intervenuar përmes operatorit Ekonomik si në Lagjen e Re në Komoran ku nga disa qytetarë është insistuar që të bëjnë ndërtime pa leje në pronen komunale, pastaj largimi i rrethojave në disa hapsira publike afer blloqeve të banesave në Drenas. Mungesa e mjeteve bugjetore për rrënime ngase vetëm 5.000,oo euro nuk ka mjaftuar për operatorin ekonomik që të intervenoj herë pas herë sipas nevojave dhe kërkesave.

Ketë vit Drejtoria për Inspeksion ka arritur që subjektet që i shfrytëzojnë hapësirat publike (terasa verore) të paisen me pelqime perkatëse nga Drejtoria e Urbanizmit.

Nuk është për t'u anashkaluar edhe puna e vështirë e punëtorëve në teren ku shpesh hasin në kërcënime, sharje e fyerje që ju bëhen inspektoreve në vendin e ngjarjes dhe në zyret e tyre. Punëtorët e kësaj Drejtorie janë në teren edhe gjatë vikendeve e ditëve të festave, gjërsa për ketë punë shtesë nuk ka pasur kurfar konpenzimi dhe kan mbetur të papaguara 80 ditë pune (640orë jasht orarit) e që kapin shumën prej 1.920,oo euro.

**Raporti i punes në shifra:**

-Procesverbale..................................154
-Aktvendime......................................51
-Fletëparaqitje....................................25
-Konkluzione.....................................06

**Nga lëmia e Inspeksionit të Komunikacionit**

Gjatë kësaj periudhe kohore nga lëmia e komunikacionit është punuar në inspektimin dhe mbikëqyrjen inspektuese në transportin publik të udhëtarëve,

Shumica e operatoreve të transportit publik janë paisur me leje operimi si autobusët, kombi-taxit, taxit e udhëtarëve nga Drejtoria për Shërbime Publike, ndersa për ata që nuk kanë qenë në rregull janë marrë masat ndëshkuese.Megjithatë vonimi i vendimit për caktimin e numrit të kombi-taxive për të operuar në teritorin e Komunes së Drenasit ka ndikuar në vonesen e mbikqyerjes nga Inspektori i Komunikacionit.Në ketë drejtim problematik në vete paraqet kapaciteti i vogel në Stacionin e Autobuseve ku krijohet tollovi e madhe dhe nuk ka vend të mjaftueshëm për parkim si dhe eksizton vete një hyrje-dalje në stacion.

Gjatë kontrollimit inspektues në trafik në shumicën e rastëve kanë asistuar edhe Policia e Stacionit Policor të Drenasit si dhe Policia e Trafikut Rajonal të Prishtinës. Megjithatë problem kryesor mbetet qarkullimi i kombi-taxive në linjat ndërurbane për derisa me ligj e kanë të lejuar qarkullimin vetëm në linjat urbano-periferike. Një problematik e tillë është në tërë teritorin e Republikës së Kosovës.

Inspektori i Komunikacionit ka qenë i angazhuar edhe në komisionin për vlerësimin e punës së kombi-taxive të angazhuar për bartjen e nxënësve nëpër disa shkolla. Për moszbatim të ligjit janë marrë masa të nevojshme si kërkesa për kundërvajtje, heqja e tabelave dhe marrja e masave tjera.

**Raporti i punes në shifra:**

-Procesverbale..............................90
-Fletparaqitje................................24
-Heqje të tabelave.........................12

**Nga lëmia e Inspeksionit të Ambientit**

Problem në vete për Drejtorinë e Inspeksionit paraqet mungesa e një Inspektori të Ambientit ( Komunal) ngase këto punë dhe detyra të punes i kryen Inspektori i Bujqësisë.

Gjatë vitit 2011 është punuar në bazë të Ligjeve, Rregulloreve dhe Udhëzimeve Administrative që e rrëgullojnë ketë lëmi ku është berë mbikëqyrja e higjenës dhe pastërtis në teritorin e Komunës së Drenasit. Një përkushtim i veçant i është bërë inspektimit dhe mbikëqyrjes së NEW CO “Feronikeli si ndotësi më i madhë i

ambientit. Edhepse nga ana e Inspeksionit Komunal të Komunës së Drenasit në bashkëpunim me Inspektoret Regjional të MMPH-së, kompanisë në fjalë i është tërhequr vrejtja me shkrim përmes procesverbaleve, aktvendimeve dhe kërkesave për fillimin e procedurave kundërvajtëse, edhe më tutje ndotja më e madhe e ambientit bëhet nga kjo kompani. Edhepse janë të vendosur filtrat ato nuk punojnë herë pas herë sidomos pasdite dhe natën, sistemi për pastrimin e gazrave nuk funksionon si duhet dhe se nga ogjaku i vjetër ka ende sasi të madhe të rrjedhjeve të gazrave me flakë.

Gjatë terë vitit është bërë mbikëqyrja dhe kontrollimi rreth hudhjes së mbeturinave në mënyr të pakontrolluar ku për këtë janë shqiptuar dënime mandatore sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2009. Gjatë terë vitit kemi pasur kërkesa të shumëta nga ana e qytetareve rredhë rrjedhjës së ujërave të zeza sidomos në zonat rurale, ndersa janë kontrolluar deponia e qytetit, siperfaqet e gjelbëruara, kontrollimi i zhurmës etj.

Ndër problemet më të mëdha gjatë vitit 2011 kanë qenë edhe shfrytëzuesit ilegal të zhavorit në disa zona ku përmes ndërprerjës së punës dhe marrjes së masave tjera nga Inspeksioni Komunal në bashkpunim me Komisionin i Minierave dhe Mineraleve si dhe Inspektorët e Regjionit të MMPH-së është arritur objektivi i plotë i ndërprerjes së punës së këtyre operatoreve ilegal të cilët më së tepërmi kanë vepruar gjatë orëve të mbrëmjës dhe ditëve të vikendeve.Këtë e ka ndihmuar edhe vendimi i Qeverisë së Kosoves për konfiskimin e mjeteve si dhe memorandumi i bashkëpunimit në mes KPMM dhe Komunes.

**Raporti i punes në shifra:**

-Procesverbale..............................44
-Fletparaqitje................................06
-Denime mandatore....................360,oo euro

**Nga lëmia e Inspeksionit të Bujqësisë**

Inspektori i Bujqësisë dhe Pylltarisë gjatë vitit 2011 ka bërë mbikëqyrjen inspkektuese me këto fushëveprimtari:

-kontrollimi i punimeve dhe shfrytëzimi i tokave bujqësore,
-kontrollimi i mirëmbajtjes së objekteve, mjeteve dhe veglave bujqësore,
-kontrollimi i farës së kulturave bujqësore,
-kontrollimi i plehërave artificiale, preparateve kimike (pesticideve) etj.

Poashtu janë kontrolluar dhe inspektuar artikujt ushqimor, kualiteti i drithit, miellit, furrave të bukës etj. Inspektori Komunal i Bujqësisë në bashkëpunimë me Inspektoret e MBZHR-së ka punuar në komisionin për evidentimin e parcelave të mbjellave me grurë të fermerëve së ai plotësojnë kushtet për subvencione në teritorin e Komunës së Drenasit.

Edhe nga lëmia e Veterinarisë janë bërë inspektime sipas kërkesës së palëve dhe sipas nevojave.

Inspektori i Bujqësisë gjatë këtij viti ka marrë pjesë në shumë komisione që kanë qenë të lidhura me këtë lëmi.

**Raporti i punes në shifra:**

-Procesverbale...............................57
-Fletparaqitje.................................04
-Aktvendime..................................01

**Nga lëmia e Inspeksionit Salitar**

Detyrë parësore e Inspektorit Sanitar në fillim të këtij viti ka qenë kontrollimi i subjekteve afariste hoteliere, kryesisht me qëllim të zbatimit të Ligjit për duhan, fillimisht është bërë inspektimi dhe dhënja e informatave të para ndaj këtyre subjekteve për zbatimin e këtij Ligji. Ndërkaq janë inspektuar 42 Restaurante dhe 17 kafiteri ku në shumicën prej tyre pas marrjes së këtyre informatave ka filluar të zbatohet ky Ligj duke vendosur shenjat për ndalim të pirjes së duhanit si dhe duke bërë ndarjen fizike prej 30% për duhanpirësit. Prandaj për mos zbatimin e këtij Ligjit në disa prej subjekteve janë hapur edhe procedura për kundërvajtje në Gjykatë (në 5 prej tyre), ndërsa nga ana e Gjykates janë zgjedhur vetem 3 prej tyre.

Gjatë muajve të veres është bërë kryesisht Inspektimi i higjenës së ushqimit, gjegjësisht, afatizimit, përgatitjes dhe vënjes në qarkullim në artikujve ushqimorë dhe sendeve të përdorimit të përgjithshëm. Ndërkaq në mënyrë të rregullt janë inspektuar sidomos markete dhe disa dyqane ushqimore në të cilat është bërë edhe asgjësimi i artikujve ushqimorë me afat të skaduar, gjithashtu është dergu kerkesa për kundërvajtje për një market.

Përveq ushqimit me afat të skaduar gjatë këtyre inspektimeve në bazë të urdhëreses së lëshuar nga Inspektoriati Sanitar i Kosovës lidhur me produktin ushqimorë-Biskota Jaffa keks e prodhuar në Serbi i cili produkt është konsideruar i dëmshëm për shëndetin, ne kemi bërë evitimin e këtij produkti në vendin tonë dhe kemi urdhëruar largimin nga shitja menjëher, ndërkaq pas kontrollave të sërishme është konstatuar se ky produkt nuk gjendet në shitje dhe është kthyer në distributori nga ana e Operatorëve ushqimorë në Drenas. Sasia e evidentuar e këtij produkti ka qenë: 97 copë (150 g) x 0.50 € = 48,50 €.

Në fillim të vitit shkollor është bërë inspektimi në institucione shkollore. Në bazë të urdhëreses të marrë nga Inspektoriati Sanitar i Kosovës për kryrjen e DDD (Dezinfektimi, dezinsektimi dhe Deratizimi) në të gjitha Institucionet parashkollore dhe shkollore, ne kemi përcjellë me kohë këtë urdhëresë në Drejtorinë e Arsimit në Drenas në mënyrë që DDD të kryhet para se të filloj viti i ri shkollor.

Poashtu krahas punëve të tjera muajin e fundit ju është kushtuar rëndësi më shumë kontrollimi i dyqaneve ushqimore (marketev) për shkak të festave të fundvitit. Vlenë të theksohet se në krahasim me vitet tjera në këtë fundvit gjendja e afatizimit të produkteve ushqimore ka qenë më në nivel.

**Raporti i punes në shifra:**

-Procesverbale............................................221
-Aktvendime................................................78
-Pranime teknike..........................................60
-Fletparaqitje................................................06
-Asgjësim të ushqimit të skaduar...............699,35 euro

*Drejtoria e Inspeksionit për vitin 2011 i ka kryer të gjitha punët rreth bugjetit të Drejtorisë dhe në harmoni me planin e zotimeve dhe shpenzimeve i ka bërë të gjitha pagesat e faturave si për mallra dhe shërbime ashtu edhe për shërbime Komunale.*

*Ndërkaq për ecjen e proceseve përpara dhe veprim më të lehtë të ekipit të Inspektorve në teren mendojmë që sa më parë të bëhet:*
*-Menagjimi i Tregut të gjelbërt në Drenas nga Komuna (pronë komunale) dhe zgjerimi i tij apo caktimi i një lokacioni të ri,*
*-Caktimi dhe përkufizimi i Tregut të kafshëve në Drenas,*
*-Caktimi dhe përkufizimi i Tregut të gjelbërt në Komoran,*
*-Pranimi i një Inspektori Financiar dhe një të Ambientit (Komunal),*
*-Dhënja e prioritetit të zgjedhjes së lëndëve në Gjykatë,*
*-Bashkpunim më i mirë me PK, si dhe*
*-Kompenzimi i punëtorve për punen jashtë orarit, gjatë ditëve të vikendeve dhe festave.*

## Drejtorati për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik

**Hyrje**

Drejtorati për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik gjatë vitit 2011 ka realizuar punët dhe detyrat sipas Planit të punës të paraparë për të gjitha lëmit përkatëse që janë kompetencë e sajë në bazë të Statutit të Komunës,Planit Zhvillimorë Komunal,Strategjisë së Zhvillimit lokal dhe dispozitave ligjore lidhur me këto lëmi.
Prioritet i këtij Drejtorati edhe gjatë kësajë periudhe raportuese ishte realizimi i shumë projekteve në lëminë e zhvillimit të Bujqësisë si dhe krijimi i një ambienti të volitshëm biznesor në mënyrë që të nxisim investitor vendorë dhe të huaj në ngritjen e NVM duke ulur shkallën e papunësisë dhe duke hapur vende të reja pune të cilat mundë të arrihen kryesisht përmes zhvillimit të sektorit privat.

**Situata e përsonelit**

Në kuadër të këti Drejtorati për periudhën raportuese kanë qenë të punësuar 12 punëtorë edhe pse sipas rregullorës mbi sistematizimin e vendëve të punës që është nxjerr nga ky Drejtorat janë të parapar 14 punëtorë,. Në bazë të skemës organizative në kuadër të këti Drejtorati kemi tri sektore me 12 punëtorë:
**Drejtori i Drejtoratit** ------------------------------- 1
-**Sektori për Ekonomi** -------------------------4 punëtorë
-**Sektori për Bujqësi** --------------------------2 “
-**Sektori i Ekonomisë së Pyjeve** ------------5 “
Gjithësejtë:..................................................12 “

**Sektori për Ekonomi**

Gjatë vitit 2011 ky sektor ka kryer këto punë dhe detyra;

**Zyra për Zhvillim dhe Biznës Biznës :**

-Raporti i punës për vitin 2010
-Hartimi i programit të punës për vitin 2011
-Bashkëpunimi me biznese për hartimin e biznës planeve të ndryshme
-Regjistrimi i Bizneseve të reja
-Riregjistrimet,,ndryshimet dhe shuarjët e bizneseve
-Organizimi i trajnimeve për Biznesët ekzistuese dhe ato fillestare
-Dhënja e këshillave dhe konsulencave
-Evidentimi i subjekteve afariste aktive që ushtrojnë veprimtarinë e tyre ne teritorin e Komunës së Drenasit
-Inkasimi i Taksës Komunale për ushtrimin e veprimtarisë biznesore
-Menagjimi i buxhetit të aprovuar sipas planit të zotimeve dhe planit të shpenzimeve për vitin 2011
-Rishikimi i prioriteteve dhe kursimeve të shpenzimeve në kuadër të Drejtoratit.
-Planifikimi i buxhetit për vitet 2012,2013,2014
-Pjesëmarrja në komisione të ndryshme Komunale të ndryshme

**QENDRA KOMUNALE E BIZNESIT (QKB)**

Pasi Banka Botrore ka rënë dakort me Qeverinë e Kosovës për të dhënë një fond për mbshtetjen e themelimit të një shërbimi nëpër Komuna që do ti mundëson qytetarve dhe kompanive të angazhuara në biznes një ambient ma të mirë.MTI-ja ka hartuar një memorandum lidhur me hapjen e QKB , i cili memorandum është nënshkruar nga Kryetari i Komunës së Drenasit dhe është implementuar sipas dinamikës së paraparë.

Shërbimi ndaj komunitetit të biznesit, i cili nuk ka ekzistuar më parë në Komunën tonë , për të gjithë ata që janë të përfshirë në biznes e ka bërë më të leht marrjen e autorizimit që ata e kanë kërkuar. Ky lloj shërbimi në mbarë botën përendimore njihet si " One Stop Shop".

"One Stop Shops" për bizneset , në kontekstin e Republikës së Kosovës quhët Qendër Komunale e Biznesit apo QKB.

QKB në Drenas është hapur me 25 maj të vitit 2011 në kuadër të Ministrisë për Tregti dhe Industri përkatësishtë të ARBK-së , ku aplikacionet e para ka filluar ti pranoj duke filluar nga data 30 maj 2011.

Roli i ARBK-së dhe puna që bëhet janë të njejta , vetëm se QKB në emër të palës në mënyrë elektronike i dërgon informatat në ARBK në mënyrë që palët të mos kenë nevojë të shkojn në Prishtinë për regjistrimin e biznesit.

ARBK-ja i kontrollon të gjitha informatat dhe dokumentet për tu siguruar se çdo gjë është në rregull dhe në mënyrë elektronike i dërgon dokumentin përkatës QKB.

Qëllimi kryesor i QKB është të mundësoj regjistrimin e bizneseve , ndryshimin e tyre , shuarjen e tyre etj. QKB jep udhëzime palëve si të regjistrojn një biznes individual , ortakri të përgjithshme , ortakri të kufizuar apo një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar , themelimin e SHA , të një biznesi kooperativë apo kompanije të huaj , po ashtu jep shpjegime rreth tatimit për bizneset, numrit fiskal , shpjegime për TVSH dhe udhëzime për plan biznese etj.

QKB-ja ka për qellim edhe riregjistrimin e bizneseve , do të thotë të bizneseve që janë të regjistruara me UNMIK në periudhën e viteve 2000-2003, e të cilat nëse vendosin të funksionojn ligjërisht duhet të bëjnë riregjistrimin e tyre.

Gjatë periodës Qershor- Dhjejetor 2011 , numri i bizneseve të reja dhe të riregjistruara ishte 126 sosh.

Në vijim po e paraqesim tabelën mbi numrin e bizneseve të reja dhe të riregjistruara sipas seksioneve dhe aktiviteteve ekonomike në periudhën Qershor-Dhjetor 2011.

| | **Nr.bizn.të regjistruara 2011** | **Nr.i punëtorve të deklaruar** |
|---|---|---|
| -Bujqësia,gjuetia dhe pylltaria........................... | 5 | 8 |
| -Industria.......................................................... | 12 | 21 |
| -Industria e mineraleve metalike........................ | 1 | 1 |
| -Industria ushqimore dhe e pijeve...................... | 3 | 7 |
| -Prodhimi i lëkurës dhe produkteve me lëkurë.... | 1 | 2 |
| -Prodhimi i kemikalieve dhe produkteve kimike (Prodhimi i lëndëve plastike)............................ | 3 | 3 |
| -Prodhimi i produkteve të tjera metalike................. | 2 | 5 |
| -Prodhime përpunues-prodhimi i mobiljeve............... | 1 | 1 |
| -Ndertimtaria................................................................ | 19 | 36 |
| -Tregtia........................................................................ | 54 | 69 |
| -Hoteljeria.................................................................... | 5 | 5 |
| -Transporti .................................................................. | 14 | 18 |
| -Veprimtari të tjera afariste.......................................... | 8 | 10 |

| | | |
|---|---|---|
| -Veprimtarit e sportit rekreacionit dhe kulturës.......... | 1 | 1 |
| -Veprimtari të tjera shërbyese.................................... | 6 | 8 |
| **Gjithësejt:** | **135** | **185** |

Aktivitetet më të prëferuara në këtë periodë janë tregtia me 54 biznese ( 40.00%) , ndërtimtaria me 19 biznese( 14.07%) , ndërsa kategorit e tjera të aktiviteteve përbëjnë pjesën më të vogël.

Sa i përket llojit të bizneseve (për nga numri i të punësuarëve) të regjistruara gjatë periodës Qershor-Dhjetor 2011 , dominojn kryesisht biznest e vogëla ( prej 1 – 9 të punësuar).

Në numrin e bizneseve të reja dhe të riregjistruara sipas seksioneve ekonomike dhe legale të organizimit në periodën Qershor- Dhjetor 2011, dominojn bizneset individuale me 95.27%, pastaj shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar me 3.15% , Ortakritë e përgjithshme me 1.57 % .

Në perioden Qershor-Dhjetor janë regjistruar 51 ndyshime të biznesët ekzistuese , të cilat kanë të bëjnë : me rritjën e numrit të punësuarve , ndyshimin e emrit të biznesit , shtimin e kodeve të veprimtarive , shtimin e njësive punuese , ndërrimin e adresave të bizneseve , ndërrim të pronarve dhe të drejtorve, ndërrim të llojeve të bizneseve dhe agjentit të regjistruar etj.

Gjatë kohës prej kur ka filluar punën QKB në Drenas , e kanë shuar veprimtarin 10 biznese , që i takojn kryesisht lëmisë së trgtisë , shuarja ka qenë vullnetare , arsyet e shuarjes parasegjithash janë : mungesa e aftësisë menagjuese , mungesa e përvojës dhe e seriozitetit e të marrurit me biznes , mungesa e trajnimeve , kushtet e pavolitshme kredi-marrëse për biznese etj.

Nëse e bëjmë një rekapitulim të bizneseve të regjistruara( bizneseve të reja ) dhe të riregjistruara duke filluar nga 01.01.2003 e deri me 31.12.2011 sipas veprimarive , që i takon regjistrimit të përhershëm , fitohët kjo pasqyrë si vijon:

Regjistrimi i bizneseve sipas veprimtarive prej 01.01.2003 deri me 31.12.2011

| Veprimtaria | Numri i bizneseve | % | Nr.punëtorve | % |
|---|---|---|---|---|
| -Bujqësia | 38 | 1.97 | 128 | 2.66 |
| -Industria | 161 | 8.37 | 1667 | 34.70 |
| -Ndërtimtaria | 225 | 11.71 | 556 | 11.57 |
| -Tregtia | 708 | 36.99 | 1174 | 24.43 |
| -Hoteleria | 139 | 7.23 | 203 | 4.22 |
| -Transporti | 341 | 18.70 | 486 | 11.11 |
| -Veprimtaritë tjera afariste | 99 | 5.15 | 295 | 6.14 |
| -Arsimi | 16 | 0.83 | 52 | 1.08 |
| -Shëndetsia | 29 | 1.50 | 37 | 0.7 |
| -Kultura | 24 | 1.49 | 24 | 0.49 |
| -vep.tjera shërbyese | 134 | 6.97 | 182 | 3.78 |
| **Gjithësejt:** | **1914** | **100%** | **4.804** | **100%** |

Nga të dhënat e paraqitura në tabelë për sektorin privat, vërehet se numri më i madh i bizneseve është i orientuar në tregti ( 36.85%) , pastaj në transport ( 17.81%) , ndërtimtari(11.75%) , industri (8.41%) e kështu me radhë , ndërsa numër më të madh të të punësuarve ka industria ( 34.70%) pastaj vjen tregtia me 24.43% , ndërsa lëmitë e tjera absorbojn një numër më të vogël të punësuarve.

**Ndërsa numëri i të punësuarëve në veprimtaritë shoqërore në fund të vitit 2011 është si vijon:**

| Veprimtaritë | Numëri i të punësuarëve | % |
|---|---|---|
| Arsimi | 897 | 66.69 |
| Shëndetësia | 277 | 20.59 |
| Organët e Adm. | 140 | 10.40 |
| Gjykatat | 22 | 1.63 |
| Kryqi i Kuq | 3 | 0.22 |
| Qendra e punësimit | 6 | 0.44 |
| **Gjithsejt:** | **1345** | **100.00** |

Kur e përfshijmë numërit e të punësuarëve në sferën e ekonomisë dhe në atë të jo ekonomisë , përfitohet e dhëna statistikore se janë gjithsejt 6149 të punësuar , numëri real i të punësuarëve sigurisht është më i madh në raport me numërin e paraqitur në tabelat e mësipërme kurë kemi parasyshë se është evident ende moslajmrimi i sakt i puëtorve të angazhuar në bizneset private.

Nëse e marrim parasysh numërin e përgjithshëm të popullsisë prej 58.579 banor(regjistrimi i fundit) dhe vlersimin se kontigjenti i popullsisë aktive paraqet shifrën prej 16.284 vetave apo 27.8% të popullsisë së përgjithshme dhe nëse e marrim parasysh edhe numërin e përgjithshëm të të punësuarëve fitohet e dhëna se në 100 banor aktiv janë 38 të punësuar.

●Projekti “One Stop Shop” i cili ësht i financuar nga Zyra ndërlidhëse e Komisionit Europian dhe i implementuar nga BSCK në Drenas ka për qellim përveç këshillimeve për biznese lidhur me legjislacionin në fuqi, me procedurat e regjistrimit dhe licencimit të bizneseve si dhe këshillimeve në këto fusha : ndërmarrsi dhe menaxhim i NVM , marketing , hulumtim i tregut , teknikat e shitjes , komunikim biznesi , financa dhe përpilim të biznes planit etj ,gjithashtu ka për qellim edhe trajnimet – informimet e bizneseve të reja dhe ndërmarrësit aspirant për konceptet bazë të ndërmarrësisë , kështu gjatë gjashtë(6)mujorit të dytë të vitit 2011 , janë trajnuar 83 përsona në fushat e lartë cekura , të cilët pas trajnimeve të bëra janë certifikuar , këto trajnime janë mbajtur nga trajner dhe ekspert të njohur dhe me përvojë të BSCK..Trajnime me Biznese fillestare jan organizuar edhe nga Prishtina REA ku kan marrë pjesë 30 pjesmarrës.

Pas këtyre trajnimeve të organizuara Biznesët e reja dhe ato ekzistuese për mes Planbizneseve të hartuara kan aplikuar për grante që jan ndarë për mbështetjën e bizneseve ku nga Komuna jonë kemi pas disa përfitues të këtyre granteve dhe me sukses kan filluar biznesët e tyre.

Edhe gjatë vitit 2011 ka vazhduar bashkëpunimi dhe pjesëmarrja në shume takime pune me Agjencionin për Zhvillim Rajonal-Qendër (AZHR)

Ka vazhduar bashkëpunimi me MTI-në rreth funksionalizimit të Parkut Industrial ku është intensifikuar puna dhe vendosja e biznesëve dhe është arritur progres në projektet e filluara.Gjithashtu ka përfunduar ndëtimi i Inkubatorit të biznesit dhe ndertimi i infrastrukturës kyqëse në Magjistralën Prishtinë - Pejë kurse pas vlersimit të punëve në teren nga Komisioni i caktuar Bordi PBD 17 Kompanive ju ka ndërprerë kontratat pasi që nukë kanë filluar fare të punojnë në realizimin e projekteve të tyre sipas dinamikës së parapar,dhe tani presim që me përmbylljen e fazës së tretë do të rrumbullaksohet e gjithë hapsira e planifikuar për biznese prodhuese dhe shërbyese pasi që janë pranuar 35 aplikacione të reja të cilat jan duke u shqyrtuar për tu vendosur në PBD.Dymbdhjet biznese jan aprovuar për vendosje në PBD dhe katër biznese veq kan filluar me sukses ushtrimin e veprimtarive të tyre.Vlenë të theksohët se shumica e biznesëve që janë pëpërfituese në Park po i zhvillojnë aktivitetet në ndertimin e objektëve biznesore sipas dinamikës së parapar dhe shumë shpejt do të fillojnë punën në veprimtaritë përkatëse.

**Papunësia**

Numri i përgjithshem i punëkërkuesve me 31.12.2011 eshte 11867 veta,prej tyre 6254 femra.

Te dhënat per nr. e pk sipas grupmoshave,gjinisë dhe strukturës kualifikuese po i paraqesim në formë tabelare. Shif tabelën.

| Grup-moshat/struk. kualifikuese | ppk | | gjk | | ku | | pmp | | plp | | psp | | gjithsejtë | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | gj | f | gj | f | gj | f | gj | f | gj | f | gj | f | gj | f |
| 16-24v. | 2319 | 1442 | 144 | 95 | 511 | 18 | 1669 | 687 | 16 | 2 | 64 | 25 | 4723 | 2269 |
| 25-39v. | 3387 | 2488 | 60 | 40 | 632 | 4 | 1208 | 303 | 15 | 4 | 95 | 37 | 5397 | 2876 |
| 40-54v. | 784 | 682 | 30 | 11 | 193 | 10 | 74 | 39 | 5 | 0 | 9 | 3 | 1095 | 745 |
| Mbi 55v. | 610 | 361 | 1 | 0 | 9 | 0 | 24 | 3 | 0 | 0 | 8 | 0 | 652 | 364 |
| Gjithsejte: | 7100 | 4973 | 235 | 146 | 1315 | 32 | 2975 | 1032 | 36 | 6 | 176 | 65 | 11867 | 6254 |

Nga të dhënat e prezantuara më lartë shifet se pjesemarrja më e madhe e punë kërkuesve është te grup-mosha e dyte(25-39 vj.) dhe merr pjesë me 45.5% në nr. e përgjithshem të punëkerkuesve.Grup-mosha prej 16-24 vjet merr pjesë me 39.8% në nr. e përgjithshëm të pk.Grup-mosha me radhë vjen ajo pre 40-54 vjet, e që merr pjesë me 9.2% në nr. e përgjithshem. Grup-mosha e fundit mbi 55vjet në nr. e përgjithshem ka pjesemarrje prej 5.5%. Nga keto krahasime të grup-moshave del se punëkerkuesit e evidentuar ne ZKP ne Drenas janë te moshes relativisht te re, e që paraqet nje komponentë te rëndësishme për fuqine punëtore më vitale të Komunës e me gjërë.Struktura kualifikuese e pk. në raport me numrin e përgjithshem është si vijon;pjesemarrjen me te larte e perbejne punëkerkuesit e pakualifikuar,ku marrin pjese me 59.8% në numrin e përgjithshem të punëkerkuesve,e që në kuader te tyre pjesën dërmuese e perbëjne punëkerkuesit e gjinisë femrore të pakualifikuara, ku pjesemarrja e tyre eshte 70.05% në numrin e përgjithshëm të pk te pakualifikuar.Punëkërkuesit me PMP përbëjnë 25.1% ne nr e përgjithshem të punëkërkuesve.Pastaj pk e KU(shkollat e mesme profesionale)marrin pjesë me 11.1% në nr. e përgjithshëm të punëkerkuesve.Punëkerkuesit me PLP kane pjesemarrje me 0.3% dhe ne fund punekerkuesit me PSP(fakultet) perbejne 1.5% të nr. të përgjithshëm të pk.Paraqitja e strukturës kualifikuese,veqmas për pk me pregatitje të larte profesionale dhe atyre me përgaditje superiore shprehur në numra relativ dukët jo e lartë,por nuk është shifër për tu nënqmuar,sepse një numër prej 200 pk me përgatitje të lartë dhe superiore profesionale paraqet nje potencial të rëndesishëm për te gjitha lëmitë ekonomike dhe shoqërore të Komunes sonë.

-Pjesëmarrja në komisione të ndryshme Komunale

Për të gjitha subjektët afariste dhe në veqanti duke patur parasysh natyrën e punës dhe sherbimin më të mirë të qytetarve tanë, barnatorëve të cilat operojnë në qendër të Drenasit ju janë lëshuar Aktvendime për caktimin e orareve të Kujdestarisë së natës.

Janë hartuar informata të ndryshme në bazë të kërkesave të Drejtorit të DBZHE dhe Ministrive të lëmive përkatëse dhe pjesëmarrja në komisione të ndryshme.

**SEKTORI I BUJQËSISË**

*Sektori për Bujqësi gjatë vitit 2011 ka kryer këto pune dhe detyra:

- Përcjellja e projekteve që janë implementuar gjatë vitit 2011 dhe që vazhdojnë te implementohën edhe gjatë vitit 2012(matrikulimit të gjedhëve, pemëtarisë,perimkultures,serave etj)
- Janë mbajtur këshillime, me grupe të fermerëve si: rreth ujitjës, pemëtari, perimkultur, blegtori ,lavertari etj.
- Bashkëpunim me Njesinë punuese "Ibër Lepenc" në Komoran për aktivizimin-zgjerimin e sistemit të ujitjës.
- Është bërë përgatitja e planit të mbjelljeve pranverore
- Është bërë përgatitja e projekteve të ndryshme (ekspozita e gjedhëve, eliminimi i qenëve endacak, projekte për pika te grumbullimi te qumështit, etj.)
- Është bërë plani për fushatën e korrje shirjës
- Është bërë mbledhja e të dhënave të statistikave bujqësore e të anketave administrative si dhe përpunimi i tyre.

- Sektorin e Bujqësisë e kanë vizituar edhe shumë fermër , të cilët i kanë paraqitë kërkesat, problemet e tyre, por edhe janë ndihmuar me dhënjën e këshillave për përmiresimin e fermave të tyre.

- Sektori i Bujqësisë ka proceduar afër 1000 fermer,në bazë të memorandumit te mirëkuptimit te nënshkruar nga Ministria e Bujqësisë dhe Kryetarit te komunës ne projektet e implementuar nga MBPZHR ,sipas Planit per Bujqesi dhe Zhvillim Rural 2007-2013,per nen masen 2.

për sektorin e pemtarise,perimkultures ,për nën masën 1,ekonomit bujqësore për prodhim te qumështit ,mbjelljët vjeshtore etj.

-Është bërë përcjellja e mbjelljeve të kulturave lavërtarë,përcjellja e fushatës për korrje shirje te drithërave të bardha janë dhëne këshilla për bujqit e interesuar, janë përgatitur informata për këto kultura dhe për rendimentet e tyre, si dhe është bërë krahasimi me mbjelljet e vitit paraprak me qëllim që të përcjellët dinamika e zhvillimit të kësaj veprimtarie. Po ashtu gjatë këtij viti janë mbajte trajnime të ndryeshme profesionale të organizuar nga sektori i bujqësisë ne bashkepunim me MBPZHR si trajnime në pemëtari ,blegtori,lavertari,perimkultur etj. Në të gjitha këto trajnime janë përfshirë një numër i madh i fermerëve .

Kulturat lavërtarë dhe realizimi i tyre sipas viteve 2010 dhe 2011

| | | 2010 | | | 2011 | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr | Kulturat | Sip. e realiz. ha | Rendi. Mesatar t/ha | Rendi.i realizuar Tonë | Sip. e realiz. ha | Rendi. Mesatar t/ha | Rendim.i realizuar Tonë | Rend.real iz. Ind. 10/11 |
| A | B | c | ç | d | dh | e | f | f/d |
| 1 | Grurë | 4370 | 3.2 | 13984 | 4200 | 4.7 | 19740 | 141.16 |
| 2 | Elb i birrës | / | | | | | | |
| 3 | Misër | 970 | 6.5 | 6305 | 1623 | 6.4 | 10387 | 164.74 |
| 4 | Tërshërë | 253 | 2.00 | 506 | 510 | 2.3 | 1173 | 231.82 |
| 5 | Patate | 56 | 25 | 1400 | 90 | 25 | 2250 | 160.71 |
| 6 | Bimë foragj. | 467 | | | 370 | | | |
| 7 | Perime | 140 | | | 160 | | | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gjithësejt | 6256 | | 8211 | 6953 | | 33550 | |

Në teritorinë e Komunës së Drenasit kanë qenë të mbjellura me drithëra të bardha gjithsejt 4710 ha.

**Korrjeshirjet:**

Nga Drejtorati për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik me kohë u bënë të gjitha parapërgaditjet për fushatën e korrje-shirjeve dhe u verifikuan të gjitha autokombajnat që mund të marrin pjesë në fushatën e korrje-shirjeve u informuan me lehtësirat –subvencionimin prej25% të karburanteve djegëse në bazë te qmimit ku për një hektar u caktuan 20 litra karburant. Të angazhuara kanë qenë gjithsejt 90 autokombajna ku prej tyre 60 autokombajna ishin me pronar nga fermer të Komunës së Drenasit,. Korrje – shirjet në Komunën tonë kan filluar me 09.07.2011 dhe kan ecur sipas planit dinamik të hartuar nga Drejtorati për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik

Me Vendimin e Komunës së Drenasit të marrë në koordinim me MBPZHR të datës 29. 07.2011 qmimi i korrje shirjeve për 1 ha.ka qenë i përcaktuar 100€, ky qmim ne teren është zbatuar me përpikëri nga të gjithë autokombajnerët .

Duke patur parasysh kushtet e volitshme klimatike dhe numrin e mjaftueshëm te autokombajnave fushata e korrje-shirjëve ka zgjatur vetëm 26 ditë kështu qe kjo fushat në teritorin e Komunes sonë ka përfunduar me sukses me dt.03.08.2011.

Vlenë të theksohët se këtë vite korrje-shirjet kan filluar me kohë

Komisioni gjatë përcjelljës së korrje-shirjëve në teren ka konstatuar këto rendimente:

Gjatë realizimit te korrje-shirjeve janë paraqitur edhe disa probleme sidomos të autokombajnat e vjetra te të cilat eshtë vrejtur humbje në sasi jasht kufijve te normalës(te hederi dhe te aparati fshirës).mesatarja e vjetersisë së autokombajnave ishte 27vjet.

Apeli me kohë drejtuar qytetarve për mosdjegëje të amulloreve (sterrnishtave)që Drejtorati ynë e ka bërë për mes Mediave,Komisionit në teren dhe Administratorve të fshatrave hasi në mirkuptim të qytetaret tanë kur dihet fakti se ka pasoja negative në shumë aspekte.ndotja e ambientit,dëmtimi i bimësisë,ekosistemit,rrezikimi i pronave të qytetarve dhe vet qytetarve etj.kështu që këtë vit nuk kemi pas djegëje masive të amulloreve në teritorin e Komunës sonë.

**Hidroekonomia**

- Sipërfaqja e përgjithshme nenë sistemin e ujitjës është 5620 ha.
- Në bazë te informatave të Ndërmarrjes Hidroekonomike "Ibër- Lepenc"deri me tani janë bërë rehabilitime te ndryshme në rrjetin e sistemit tëujitjës ku tani mund te ujiten rreth 3000 ha.
- Ujitja ka filluar me 14.06.2011, kryesisht është ujitur fusha e Terstenikut,Gllobarit dhe fusha e Baicës me një sipërfaqe prej 115 ha.
  Dhe 135 ha në Fsh.Zabel i Ulët ,Korroticë e Ulët,Komoran 1 dhe 2 Zabel i lartë e tj.Qmimi i ujitjës për një ha.ka qenë 100€

**Projektët e implementuara nga Sektori i Bujqësisë në vitin 2011**

Projekti: Eleminimi i qenëve endacak në teritorin e Komunës së Drenasit

Projekti ka filluar te implementohet nga Drejtoria për Ekonomi dhe Bujqësi, qysh prej vitit 2005, me herët ky projekt ka qenë i implementuar nga Drejtoria e Emergjencës, do të zgjatë deri të (zvogëlohet rreziku) bëhët eleminimi i qenëve endacake. Komuna e ka përkrahur këtë projekt për shkak të rrezikueshmërisë së qytetarëve. Projekti në vlerë prej 5.000€ është financuar nga Komuna,Monitorimi i implementimit te projektit është bërë nga

Drejtoria e Bujqesise dhe Inspekcionit ,kurse eliminimi është berë nga Shoqata e Gjuetareve”Drenica 1”në Drenas. Eleminimi i qenëve endacak në teritorin e KK.Drenasit është kryer në të gjitha fshatrat e Komunës sonë sipas planit te hartuar më herët si dhe në bazë të kërkesave emergjente të qytetarve.Në bazë të Raportit të Komisionit monitorues të eleminuar gjithsejt ishin mbi 500 copë.

Ky projekt rritë sigurinë e të gjithë qytetarëve e posaqërisht fëmijëve dhe nxënëseve të cilët janë shtresa me e pa mbrojtur dhe më e rrezikuar.

**Projekti: “Ndërtimi i 30 serrave në teritorin e Komunës së Drenasit”**

Hartimi dhe implementimi i projekti eshte bere nga sektori I bujqesis e
i , financuar nga Kuvendi Kumunal –Drenas,
Gjëndja e tanishme e sipërfaqeve me serra në Komunën e Drenasit,as për se afermi nuk i ploteson kërkesat e tregut me perime,atëherë duhet të rritën sipërfaqe me këto projekte të rëndësishme të cilat bëjnë furnizimin me perime të freskta gjatë tërë vitit, nga aspekti ekonomik arrihën rendimente mjaft të larta në afate kohore të planifikuara.
Përparësi e kultivimit të perimëve në sera:
-Shfrytzimi me racional i tokës bujqësore
-Zbutja e karakterit sezonal të prodhimtarisë perimore
-Rritja e produktivitetit
-Rritja e cilësisë se projektit
-Furnizimi i tregut me artikuj te freskët
-Hapja e vendeve te reja te punës
-Zvogëlimi i importit etj.Në këtë projekt ,përfitues jane 30 fermer ,me nga nje ari serrë,vlera e projektit ka qene 30.000 ero.Per nje serë vlera ka qene 1000 ero,80% financuar nga Kuvendi Komunal-Drenas,20% participimi nga fermeret(200 €).

**Projekti: “Ndërtimi i plantacioneve të pemeve-mollë prej 0.20-0.50 ha”**

Përfitues kane qene 53 fermer me një siperfaqe të përgjithshme prej afro 20 ha.
Është punuar ne projektet e implementuar nga MBPZHR sipas Planit per Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2007-2013 , në kuadër të ketyre masave mbështetëse :
**1 »Ekonomitë bujqësore prodhuese të vezëve«,**
**2 »Ekonomitë bujqesore prodhuese te qumeshtit «**
**3 » Ekonomitë bujqesore prodhuese -Pemtari,perimtari dhe vreshtari«.**
Rreth 30 fermer janë paisur me aplikacione per grande , jane dhënë këshilla për mbushjen e formularëve si dhe eshte bere pranimi i formularëve dhe dergimi ne MBPZHR.
Projektet jane me vlera te ndryshme ne baze te sektoreve jane te caktuara limitet (max dhe minimumi) financimi është bërë:
50% nga ministria ,50% participim nga fermeret .Në këto projekte kanë përfituar disa farmer tanë si në lëminë e perimkultuarave ,fermave për lop qumshtore,ferrma të pulave,pemishte e tj.ku shuma e pëgjithshme e këtyre projekteve është 134.000 €
Gjithashtui në bashkpunim me MBPZHR kemi realizuar projektin e GLV-së për kompletimin e sheshit dhe parkut të qytetit të Drenasit me ulëse,vazo lulesh,shporta për hedhurina.

**Blegtori :**

Subvencionimi i lopëve qumeshtore-kane aplikuar 64 fermër me 455 krerë lopë qumshtore ku për një krerë farmerët kan përfituar 50 € dhe shuma e përgjithshme që kan përfituar farmerë është 22.750 €

Subvencionimi deleve dhe dhive qumeshtore-kane aplikuar 39 fermër me 3929 krere ku për qdo krer fermeret kan përfituar nga 10€ dot thot shuma e përgjithshme që kan përfituar farmerët tanë ështe 39.290 €.
Të gjithe fermeret jane paisur me aplikacione si dhe jane ndihmuar ne mbushjen e tyre si dhe në hartimin e projekteve gjegjëse.

**Lavertari:**

Nga subvencionimi i mbjelljeve vjeshtore 2010/11
Kanë përfituar 447 fermer me sipërfaqe të përgjithshme prej 1.613.09 ha.ku për një ha. të mbjellur me grurë farmerët janë subvencionuar nga 100€ dhe vlera totale që kanë përfituar farmerët e Komunës tonë ishte 161.300 ero.

**Projekti për sobvencionim të kulturave vjeshtore 2011/12.**

Numëri i fermëreve te cilët kanë bërë digjitalizimin e parcelave dhe kanë dorzuar aplikacionet për mbjellje vjeshtore ka qenë 513 fermer,sa do të perfitojnë ,pritët verifikimi në tre mujorin e parë të këtij viti pasi të verifikohën sipërfaqët e mbjellura nga Komisionet e MBPZHR.Gjithashtu në bashkëpunim me IADK-në që është implementuese e Projektit të KE për zhvillimin e Agrokulturës ku më kët rast kanë për fituar 3 farmer nga Komuna jonë të cilët kan ngritur nga 0.50ha pemishte me kumbull dhe një Serë me sipërfaqe prej 3 ari.

Përgaditja e informatave dhe raporteve të ndryshme sipas kërkesës së Drejtorisë dhe Ministrive përkatëse.

**SEKTORI I PYLLTARISË**

Mbrojtja e pyjeve nga prerësit ilegal dhe nga zjarrët si dhe pyllzimet dhe ripyllzimet e sipërfaqëve të gjveshura e ishte dhe do të jet prioritet në vazhdimsi i DBZHE e posaqërisht i stafit të Sektorit të pylltarisë.

**Pyllzimet**

Edhe gjatë vitit 2011 ka vazhduar pyllzimi i sipërfaqëve të gjveshura ku
në objektin e “Qyqavicës”, në vendin e quajtur “Djerrinat e Likoshanit”, në Likoshan janë pyllëzuar 10 ha me pishë si dhe 2 ha në vendin e quajtur “Kokil”.

**- Konfiskimet:**

Gjate vitit 2011 janë konfiskuar 17.72 m3.dru dhe në marrveshje me APK-në kemi formuar një Komision i cili ka shqyrtuar kërkesat e drejtuara në DBZHE dhe kjo mase drunore ju është ndarë familjeve në varfëri të skajshme. Me ketë masë drunore janë furnizuar 13 familje ku vlera e e përgjithshme e kësaj mase vlersohët të jetë 886 €.

**- Ndërhyrja silvikulturore**

Gjatë vitit 2011 janë bërë ndërhyrje në rrallime me qellim të ngritjës së kapaciteteve-rritje në gjatësi dhe diametër. Veprimet silvikulturore jane bërë në dy objekte-lokacione.: Në objektin e Pallanikut në vendin e quajtur;”Ballishte”, ku janë trajtuar 33 ha dhe masë drunore prej 287.70 m3., ku me këtë masë drunore janë furnizuar 101 familje, kurse në objektin e “Qyqavices”, në vendin e quajtur “Livadhi i Ali Haxhes” në sipërfaqe prej 19 ha me vëllim prej 70.30, ku 54 familje jane furnizuar me masë drunore nga këto rrallime. .Rrallimet janë kryer sipas planit dhe nën mbikqyrjën dhe monitorimin e zyrtarve të DBZHE dhe APK-së.

**-Zjarret**

Gjatë vitit 2011 në objektin e “Qyqavices” në Qyqavicë në dy paralele kanë ndodh një zjarr i përmasave të larta ku ka shkaktuar dëme të konsiderueshme pyjore . Stafi i Autoritetit pyjorë të Komunës së Drenasit ka informuar menjëher Njësinë e zjarrfikësve dhe me sukses janë lokalizuar zjarret e shkaktuara si preventivë për moszgjerimin e tyre në gjithë objektin e Qyqavicës.

**Fletparaqitjet e rojëve të pyjeve**

Gjatë këti viti janë ngritur 55 fletëparaqitje .Prej tyre 32 kundërvajtës në masë drunore 50.88 metra kub në vlerë 4.214.50€ .Kurse penale 23 fletëparaqitje me 93 .24 metra kub në vler 8.731.00€.Gjithsejt totali i përjithshëm është 144.12 metra kub në vlerë prej 12.945.50€.

**Kërkesat për Leje të prerjeve të druve në Pyjet private**

Ne pyjet private gjate ketij viti kemi pas 31 kerkesa prej te cilave te shqyrtuara kan qene 14 sosh, ndersa jan vulos 127.08 m3. Prej tyre 91.92 m3, jane damkosur nga ana jone kurse jane percjellur me fletparaqitje 16 cope me sasi prej 48 m3.Nga taksa për pyje private gjatë kësajë periudhe janë rtealizuar te hyra:në shumë prej 254 €.
Veshtërsi në realizimin e kërkesave të pronarve në pyjet private kan qenë evidente për shkak se qekani për dëmkosjen e trungjeve është mbetë ende kompetencë APK-së dhe me këtë rast kemi vonesa në procedimin e realizimit të kërkesave të palëve në teren.Ne e kemi ngritë këtë qështje disa herë porë ende nuk janë ndërmarrë veprime konkrete nga MBZHR.

## Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport

Në mbështetje të Ligjit për Qeverisjen Lokale,në vështrim të nenit 76,pika 1, të Statutit të Komunës se Drenasit dhe nenit 86 Drejtori i Drejtoratit për Kulturë,Rini dhe Sport paraqet këtë:

**Përmbajtja**

- Pjesa e përgjithshme
- Organizimi i brendshëm struktural
- Vazhdimësia e veprimtarisë DKRS,
- Prioritetet e veprimtarisë:

a)Sofra poetike,,Ymer Elshani 2011”
b)Festivali i humorit,, Drenasi 2011”
c)Festivali i grupeve kulturo-artistike

- Turniret memorile,garat e shkollave fillore,kroset komunale,zgjedhja e sportistit të vitin 2011.
- Muaji i rinisë

***Hyrje***

DKRS e komunës së Drenasit edhe më tutje vazhdon të përkrahë zhvillimet e gjithëmbarshme kulturore,sportive dhe rinore.Puna dhe aktiviteti i saj është mbështetur në Dispozitat e Ligjit për Qeverisje Lokale, në mbështetje të nenit 76 të pikës 1 të Statutit të komunës së Drenasit dhe nenit 86.Jemi njëra ndër komunat që ka më së shumti aktivitete kulturore dhe sportive,dhe këtë synim vazhdojmë ta kemi edhe në të ardhmen,sepse kjo synon përfshirjen e një numëri sa më të madh të të rinjëve në jetën kulturore dhe sportive.

Sa i përketë arkivit komunal ai punon në kushte tjo edhe aq te mira, në lokal të ngushtë dhe të papërshtatshëm me numër të paket punëtorësh të cilët nuk arrijnë të grumbullojnë,të seleksionojnë dhe të arkivojnë lëndën.

Mbështetur në programin e punës Drejtorati i Kulturës,Rinisë dhe Sportit aktivitetin e ka shtrirë në tri sektore,të Kulturës,Rinisë dhe Sportit dhe në dy institucione,Arkiv dhe Bibloteka.

## O R G A N I Z I M I I B R E N D S H Ë M

Për realizimin sa më të sukseshëm të të gjitha detyrave dhe obligimeve që burojnë nga sfera e Kulturës,Rinisë dhe Sportit e objektivave tjera që përfshinë ky rrafsh ,për përmbushjen e synimeve për t'i plotësuar kërkesat e auditorit që konsumon vlerat kulturore e për të kryer sherbimet e përgjithëshme DKRS-ja kishte angazhuar një staf si:

## SEKTORI I KULTURËS

Gjatë vitit 2011 Sektori i Kulturës duke u bazuar në Programin e punës për aktivitetet kulturore,tubimet përkujtimore dhe festat shtetrore pati në dispozicion mjete për kryerjen e këtyre aktiviteteve të cilat ishin të shumëta.Kemi kryer me sukses si: 17 shkurti dita e Pavarsisë;14 qershori dita e çlirimit të Drenasit,28 shkurti Beteja e Likoshanit-Qirez,Festat e Nëntorit,Sofra poetike,Ditët e humorit, Festivali i GKA,java e filmit dhe koncerte tjera më grupe muzikore kosovare dhe jashtë.

- Sivjet për herë të tretë festuam 17 shkurtin Ditën e Pavarsisë me një program të zgjedhur artristik me këngë e valle të SHKA,,Shotë Galica" të komunës sonë.
- Manifestimi letrar sofra poetike,,Ymer Elshani 2011" u mbajtë me 15 prill 2011 në Shtëpinë e Kulturës në Drenas në pranin e 400 adhuruesve të fjalës së shkruar dhe me prezencën e një pjese të shkrimtarëve të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës dhe Karvani i Shkrimtarëve për Fëmijë ,,Agim Deva".
- U mbajt java e filmit në Drenas prej datës 25 – 29 prill 2011,ku tri herë në ditë u shfaq filmi i Halil Budakovës,,Azem Galica".
- Me 14 qershor ditën e çlirimit të Drenasit në ora $16^{00}$në shtëpinë e kulturës u mbjatë akademi solemne.Në ora $18^{00}$në skenën e madhe në Sheshin,,Fehmi Lladrovci"u mbajtë një koncert i madhë festiv me pjesëmarrjen e Ansamblit Shtetëror të këngëve dhe valleve nga Tirana.
- Manifestimi ,,Ditët e Humorit Drenasi 2011" u mbajtë nga data 15 deri me 17 nëntor.Morën pjesë 10 kumuna me teatro,grupe dhe individ .Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve ishte 193.
- Festivali i 49 –të me radhë i grupeve kulturo-artsitike u mbajtë nga data 23 deri 25 nëntor.Në këtë Festival pikat më të mira ishin kryesisht ishin këngët popullore e sidomos ato për fëmijë. Befasi e këndshme këtë vit ishte paraqitja e grupit artistik të shkollës fillore ,,Halil Bajraktari" Drenasi II dhe ai i shkollës fillore,,Fazli Grajqevci"Paklek-Vasilevë.
- SHKA,,Shotë Galica"mori pjesë në shumë Festivali si mbrenda dhe jasht dhe në emsione të shumëta televizive.Nga këto festivale janë kthye më mirënjohje,çmime të para,të dyta etj.
- Teatri i të rnjëve vuri në skenë dy pjesë teatrale.,,Otello"dhe ,,Tomi e gjeri"
- Me 31 tetor 2011 grupi muzikor i frymorëve nga SHBA-të –Kampi i Bonstilit mbajti një koncert në Sheshin,,Fehmi Lladrovci" në Drenas dhe me 03 nëntor në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane në ora $16^{00}$në shtëpinë e Kulturës u mbajtë një koncert nga Kuarteti i Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
- Me 26 nëntor në sallën e kulturës u mbajtë një akademi festive dhe koncert solemn për nderë të 28 nëntorit.
- Me 01 dhjetor u mbajtë një koncert dhe pjesë teatrale nga OJQ e komunës sonë për nderë të ditës ,,luftë kundër AIDS-it"Ishte një pjesë jashtëzakonisht e mirë që e luajtën nxënësit e shkollës së mesme të Lipjanit me një temë që kishte të bënte me luftën kundër AIDS-it.
- Gjatë vitit 2011 Sektori i Kulturës me rastin e përvjetorëve të dëshmorëve,festave të shkollave fillore,turnireve të ndryshme sportive,akademive,shfaqjeve,koncerteve,rivarrimeve etj. bëri dekorimin dhe mbajti zërimin në të gjitha tubimet që u mbajtën në komunën e Drenasit.

## SEKTORI I RINISË

Aktivitet e Sektorit të Rinis kanë qenë të larmishme ashtu siq ishin paraparë me planin vjetor.

- Është mbajtur trajnimi me tre përfaqësues të rinisë për politikat dhe menagjimin publik kjo është realizuar në bashkëpunim e Sportit.
- Janë mbajtur ligjerata për ruajtjen e ambientit nëpër zona rurale.
- U mbjatë takim pune me grupet rinore dhe OJQ e komunës për informim rreth aktiviteteve rinore të këtij Sektori.
- Doli Revista,,Relaiteti”
- Është mbajtur muaji i Rinisë me një varg aktivitetesh të larmishme rinore,sportive e kulturore.
- Si aktivitet janë ligjëratata dhe debatet për SIDEN si sëmundje e shekullit dhe fatëkeqësishtë ende e pa shërueshme ku këtë vit janë mbajtur në shkollën e mesme, dy ligjërata pra për të dyja ndërrimet ku më të vërtet janë ndar të kenaqur jo vetem nxënesit por edhe mësuesit për efektin e arritur.
  Janë shpërnda edhe fletushka për vetëdijësimin e rinisë.

## SEKTORI I SPORTIT

- Sektori i Sportit gjatë vitit 2011 e ka realizuar ne tërësi programin e punës si :
- U kompletuan dokumentacionet për klubet sportive për ndihmë materiale,për kootizim dhe licencim;
- Për nderë të ditës së pavarësisë së Kosovës,Drejtorati për Kulturë,Rini dhe Sport organizoj aktivitete,turnire sportive me institucione,rini,sportist në Futboll të Vogël ku morën pjesë 10 ekipe,
- U mbajtë turnirin për nder të Betejës së Likoshan-Qirez dhe futbollistit Driton Ahmeti nga data 25-28 shkurt 2011 .
- Krosi komunal pranëveror 2011 u mbajt me datën 29.04.2011e ku morën pjesë gjithsësejt 25 shkolla fillore dhe dy shkollat e mesme të komunës së Drenasit.Numri i përgjithshëm i atletëve ishte 350 të dy gjinive dhe të gjitha kategorive.
- U bënë vizita klubeve sportive në ushtrime dhe në ndeshje kampionale dhe për kup.
- Pati takime me përfaqësuesit e klubeve:KH,,Drenica” ,KV,,Gryka” dhe KF,,Feronikeli”rreth vështirësive financiare për fillimin e sezonit pranveror.
- Sektori i sportit prezentoj në shumë mbledhje që u mbajtën nga klubet tona sportive;
- Garat e shkollave fillore u mbajtën prej datës 13 maj deri me 06 qershor 2011.Garat u zhvilluan në futboll të vogël,hendboll (mashkujt) dhe(femra)volejboll(mashkujt)dhe (femrat).
  Në këto gara morën pjesë 25 shkolla fillore dhe u arriten këto rezultate:
- Nga data 20 deri me 30 maj 2011 u mbajtë Turniri Memorial Tradicional në futboll të vogël ,,Rasim Kiqina”ku morën pjesë 108 ekipe nga e gjithë Kosova.Këtë vit ky turnir u mbajtë nën patronatin e Kryetarit të Komunës.
- Në krosin komunal vjeshtor 2011 i cili u mbajtur me datën 28.10.2011 , morën pjesë gjithsësejt 24 shkolla fillore dhe dy shkollat e mesme të komunës së Drenasit.Numri i përgjithshëm i atletëve ishte 345 të dy gjinive dhe të gjitha kategorive.
- Pati takime me departmentin e Sportit rreth palestrës sportive.
- Komuna e jonë është përfituese e ndërtimit të një fushe të futbollit të madhë,ku të gjitha dokumentacionet e kërkuara dhe caktimi i lokacionit është bërë me kohë dhe sipas kërkesës se donatorit.

- Turniri për dëshmorët e KH,,Drenica"u mbjatë në sallën e shkollës së mesme në Malishevë me datën 14.12.2011.
- Drejtorati për Kulturë,Rini dhe Sport më të mirët i shpërbleu me kupa,mirënjohje dhe fanela sportive. Me mirënjohje u nderuan edhe familjarët e dëshmorëve të KH,,Drenica" Drenas.
- Manifestimi për zgjedhjen e sportistit të vitit 2011 u mbajtë 16.12.2011 ne restorantin,,Lumi" ku ishin të pranishëm shumë sportist,spordashës ,Struktura komunale dhe të tjerë të ftuar. U zgjodhën 9 sportistë më të mirë të vitit,klubi më i sukseshëm,punëtori sportiv, arsimtari më i suksesshëm,shpresa,gjyqtari më i mirë sportiv dhe sportisti i vitit.

## ARKIVI KOMUNAL HISTORIK

Gjatë vitit 2011 Arkivi ka kryer këto punë:

- Rregullimi evidentimi në kompjuter,vendosja në rafta e shtypit ditor:Koha ditore,Zëri,Epoka e re,Info-pres.
- Eshtë rregulluar materiali në depon arkivore ku është bërë klasifikimi,renditja dhe vendosja në rafta.
- Eshtë bërë përpunimi,evidentimi ,rregullimi i lëndës së Drejtoratit për ekonomi dhe Financa 16 regjistrator me lëndë arkivore, gjysmë përpunimin e lëndës së Drejtoratit të Arsimit 2 regjistrator me lëndë arkivore,rregullimi dhe sistemimi në rafta i ditarëve të shkollës fillore,,Emin Duraku"Arllat;klasifikimi i lëndës së fondit të LSPP-së dhe vendosja në rafta, renditja e librezave të amzës të shkollave fillore:,,Jeta e re"Komoran 1950-1956; ,,Bajram Currit"të Nekocit 1950-1956 dhe ,,Zenel Hajdini"të Terstenikut 1950-1960.;
- Skanimi i lëndës së LSPP-së;

- Mirëmbajtja,ajrosja e depos arkivore,kontrollimi dhe kujdesi nga ndonjë fatkeqësi e mundshme.
- Gjatë kësaj periudhe janë sherbye me dokumetacione të ndryshme 28 palë si: dokumente të lokaleve afariste, dëftesa për shkollën e kryer etj.

## BIBLOTEKA

- Gjatë vitit 2011 në këtë bibliotekë janë regjistruar rreth 113 anëtar,janë dhënë në lexim 801 libra dhe ai numër i librave është marrë në pranim .Biblioteka në Drenas ka një fond prej 5632 librash me 1236 tituj.;Po këtë vit kjo bibliotekë është pasuruaredhe me një fond prej 450 ekzemplarësh dhe 41 tituj, literaturë për fëmij,romane etj.
- Janë përpiluar dhe inventarizuar 125 libra në mënyrë dhe janë kryer punë administrative për bibliotekë.
- Biblioteka në Qëndresë ka një fond prej 3350 ekzemplar me 627 titujve.Në biblotekën në Qëndresë janë regjistruar 73 anëtar të rinjë,janë dhënë në lexim 360 libra.Kjo bibliotekë ka rreth 300 lexues prej të cilëve 170 aktiv.Janë kryer edhe punët tjera si përpunimi,katalogimi,klasifikimi dhe renditja e librit.
- Biblioteka e Arllatit ka një fond prej 800 tituj dhe 4980 ekzemplaresh.Gjatë vitit 2011 në Biblotekën e Arllatit janë regjistruar 98 anëtar të rinjë kurse janë dhënë në lexim 9620 libra .Gjatë këtij viti kjo bibliotekë ka pasur rreth 776 lexues. Janë kryer edhe punët tjera si përpunimi,katalogimi,klasifikimi dhe renditja e librit.

**PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI PËR VITIN 2011**

<table>
<tr><td>Nr.</td><td>Lloji i planifikimit-Realizimit</td><td>Planifikimi</td><td>Realizmi</td><td></td></tr>
<tr><td>1.</td><td>Paga dhe mëditje</td><td>50.661</td><td>52.510,16</td><td></td></tr>
<tr><td>2.</td><td>Sherbime dhe mallra</td><td>25260</td><td>18.091,61(Aktivitete)+7.168,39<br>Material shpenzues = 25.260</td><td></td></tr>
<tr><td>3.</td><td>Subvencione</td><td>26.000</td><td>26.000</td><td></td></tr>
<tr><td>4.</td><td>Komunali</td><td>360</td><td>244,37</td><td>115,63</td></tr>
<tr><td>5.</td><td>Kapitale</td><td>55000</td><td>15000(bina dhe zërimi)</td><td>40.000 (Kulla e Shaban Polluzhës)</td></tr>
<tr><td>6.</td><td colspan="4"><u>Sqarim:</u>Projekti i kullës nuk është realizuar për arsye se është bërë një kërkesë e ndryshimit të tij dhe më pas është shpallur tenderi dhe konkuruesit kanë qenë mbi zotimin e mjeteve dhe është përsëritur për herë të tretë,ku është shpallur fituesi,por për shkak të mbarimit të vitit nuk është nënshkruar kontrata e punës.Projekti në tërësi ka kaluar në Ministrinë e Kulturës dhe do të realizohet komplet në vitin 2012 për të cilin janë siguruar të gjitha mjetet nga Ministria e Kulturës për koston e projektit.</td></tr>
<tr><td>4.</td><td>Kultura</td><td colspan="3">- Pjesëmarrja e SHKA në festivale,iniqizime,koreografi;<br>- Sofra poetike; Teatri; Festivali i GKA-ve;Humori;<br>- Pajsija e bibliotekave me literaturë; Zërimi,dekorimi(dita e pavarsisë dhe dita e çlirimit)...............................5.390,00€<br>-Transporti..........................................2.063,61€<br>- Ndihmë shoqatave dhe individëve........888,00€<br>Gjithësejt...............8.341,61€ Mallra dhe sherbime<br>................ 10.248,00€ Subvencione<br>TOTALI :....................18.589,61€</td></tr>
<tr><td>5.</td><td>Sporti</td><td colspan="3">- Ndihmë klubeve dhe shoqatave sportive.............15.752€<br>- Aktivitetet sportive ..............................................7.000€<br>Gjithësejt...........7.000€ Mallra dhe Sherbime<br>.......15.752€ subvencione<br>TOTALI:.........22.725€</td></tr>
<tr><td>6.</td><td>Rinia</td><td colspan="3">- Aktivitetet rinore........................2.750€<br>TOTALI:....................................2.750€ Mallra dhe sherbime</td></tr>
</table>

**Kryetari i Komunës**

**____________________**

**Nexhat Demaku**